

KUSHTETUTA
E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT
ME AMENDAMENTET E KUSHTETUTËS I-XXXVI

Shkup, korrik 2020

**KUVENDI I REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË
VERIUT**

**SHËRBIMI
I KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË
VERIUT**

**KUSHTETUTA
E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT
ME AMENDAMENTET E KUSHTETUTËS I-XXXVI**

PARATHËNIE

Botimi ofron pasqyrë të plotë në dispozitat e Kushtetutës së Republikës të Maqedonisë të miratuar më 17 nëntor të vitit 1991 dhe Amendamentet I dhe II të miratuara në janar të vitit 1992, Amendamentin III të miratuar në korrik të vitit 1998, Amendamentet IV deri XVIII të miratuara në nëntor të vitit 2001, Amendamentin XIX të miratuar në dhjetor të vitit 2003, Amendamentet XX deri XXX të miratuara në dhjetor të vitit 2005, Amendamenti XXXI i miratuar në janar të vitit 2009, Amendamenti XXXII i miratuar në prill të vitit 2011 dhe amendamentet nga XXXIII deri XXXVI të miratuar në vitin 2019, të cilat janë pjesë përbërëse të Kushtetutës. Gjithashtu, në Botim janë të përmbajtura edhe Ligji kushtetues për zbatimin e Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë, Ligji kushtetues për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit kushtetues për zbatimin e Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë, Ligji kushtetues për zbatimin e amendamenteve nga XX deri XXX të Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë dhe Ligji kushtetues për zbatimin e amendamenteve nga XXXIII deri XXXVI të Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë.

Me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë të vitit 1991, si akt themelor politik dhe akt më i lartë juridik i shtetit, është rumbullakuar procesi i gjatë historik në krijimin dhe konsituimin e Republikës së Maqedonisë si shtet sovran dhe i pavarur, sovraniteti i të cilit është i pandashëm, i patjetërsueshëm dhe i pambartshëm. Si vlera themelore të rendit të ri kushtetues, Kushtetuta i përcaktoi liritë dhe të drejtat e njeriut dhe qytetarit, të shprehurit e lirë të përkatësisë nacionale, ndarjen e pushtetit shtetëror në ligjvënës, ekzekutiv dhe gjyqësor, sundimin e së drejtës, pluralizmin politik etj.

Në Kushtetutën e vitit 1991, janë bërë më shumë ndryshime dhe plotësime, me miratimin e amendamenteve prej I deri XXXVI. Këto ndryshime ishin rezultat i gjendjeve të caktuara politike në planin e brendshëm dhe ndërkombëtar, i rrjedhave shoqërore, si dhe i perceptimeve që rezultuan nga zbatimi i zgjidhjeve kushtetuese për

nevojën e përsosjes së sistemit kushtetues dhe krijimin e premisave kushtetuese për demokratizimin e mëtejshëm të shoqërisë.

Në vitin 1992 u miratuan amendamentet I dhe II të Kushtetutës, me të cilat u afirmuan standarde të caktuara ndërkombëtare.

Miratimi i Amendamentit III në vitin 1998, rezultoi nga nevoja për vazhdimin e kohëzgjatjes së paraburgimit.

Me amendamentet IV – XVIII të Kushtetutës, miratimi i të cilave ishte rezultat i Marrëveshjes Kornizë të nënshkruar më 13 gusht 2001, janë bërë ndryshime dhe plotësime të rëndësishme të Kushtetutës, si në Preambulë ashtu edhe në një numër të madh të dispozitave në pjesën e saj normative. Me këto amendamente janë ndryshuar dhe plotësuar dispozitat e Kushtetutës që kanë të bëjnë me gjuhët zyrtare dhe përdorimin e tyre, të drejtat e pjesëtarëve të bashkësive, mbrojtjen e pasurisë historike dhe kulturore të Republikës, punën e Kuvendit të Republikës së Maqedonisë, procedurën dhe shumicën e nevojshme për nxjerrjen e ligjeve të veçanta, zgjedhjen dhe kompetencat e Avokatit të Popullit, Komitetin për Marrëdhënie Ndërmjet Bashkësive, vetadministrimin lokal, një pjesë të procedurës për ndryshimin e Kushtetutës etj. Zgjidhjet e inkorporuara në këto amendamente, kanë ndikim të rëndësishëm në sistemin e përgjithshëm kushtetues juridik të shtetit.

Me Amendamentin XIX u përcaktua mundësia dhe rastet për shmangie nga parimi i pacenueshmërisë së letrave dhe formave të tjera të komunikimit, si parakusht për veprimin preventiv dhe efikas, të organeve kompetente hetuese dhe gjyqësore. Kjo njëkohësisht do të thotë krijim të bazës kushtetuese për harmonizimin e legjislacionit tonë, me të drejtën e Bashkimit Evropian në këtë fushë.

Me miratimin e amendamenteve XX deri XXX, u bënë ndryshime thelbësore të zgjidhjeve ekzistuese kushtetuese, në fushën e sistemit të jurisprudencës. Me këto ndryshime u krijuan premisa kushtetuese për reforma në jurisprudencë, në drejtim të forcimit të pavarësisë dhe mëvetësisë së saj, rritjes së efikasitetit dhe funksionalitetit. Me miratimin e këtyre amendamenteve, u sigurua që

në Kushtetutë të inkorporohen standarde relevante evropiane në fushën e drejtësisë, të përcaktuara në dokumentet ndërkombëtare nga kjo fushë.

Me Amendamentin XXXI është bërë ndryshim në paragrafin 5 të nenit 81 të Kushtetutës, në drejtim të uljes së censusit të votuesve në rrethin e dytë, i nevojshëm për zgjedhjen e Presidentit të Republikës.

Me Amendamentin XXXII është përcaktuar mundësia për ekstradimin e shtetasit të Republikës së Maqedonisë një shteti tjetër ose shteteve të tjera, në bazë të Marrëveshjes së ratifikuar ndërkombëtare, me vendim gjyqësor, si bazë për inkuadrimin e shtetit tonë në luftën kundër krimit të organizuar rajonal dhe ndërkombëtar.

Me Amendamentet XXXIII deri XXXVI u miratuan për implementimin e Marrëveshjes përfundimtare për zgjidhjen e dallimeve të përshkuara në rezolutat 817 (1993) dhe 845 (1993) të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, për shfuqizimin e Marrëveshjes së Përkohshme të vitit 1995 dhe për vendosjen e partneritetit strategjik ndërmjet palëve, të nënshkruar më 17 qershor 2018 në Prespë, Greqi. Me Amendamentin XXXIII, në Kushtetutë fjalët: "Republika e Maqedonisë" zëvendësohen me fjalët: "Republika e Maqedonisë së Veriut", ndërsa fjala "Maqedonia" zëvendësohet me fjalët: "Maqedonia e Veriut", përveç në nenin 36 të Kushtetutës. Me Amendamentin XXXIV janë bërë ndryshime në Preambulë, me Amendamentin XXXV është plotësuar neni 3, ndërsa me Amendamentin XXXVI është zëvendësuar neni 49 ekzistues dhe Amendamenti II i Kushtetutës.

Botimi me përmbajtjen e vet dhe me zgjidhjet teknike dhe grafike, në paraqitjen e tekstit të Kushtetutës dhe të amendamenteve prej I deri XXXVI, ofron pasqyrë të qartë dhe përmbledhëse në tërësinë e dispozitave kushtetuese.

Botimi, shpresojmë se do të sigurojë qasje më të lehtë në zbatimin dhe shfrytëzimin e Kushtetutës nga ana e deputetëve në Kuvend, gjatë ushtrimit të funksionit të tyre ligjvënës dhe kontrollues

politik dhe rolit të pjesëmarrësve të drejtpërdrejtë, në përsosjen e sistemit kushtetues dhe juridik të shtetit.

K U S H T E T U T A
E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT
ME AMENDAMENTET E KUSHTETUTËS I-XXXVI

*)

Duke u nisur nga trashëgimia historike, kulturore, shpirtërore dhe shtetërore e popullit maqedonas dhe nga lufta e tij shekullore për liri nacionale dhe sociale dhe për krijimin e shtetit të vet, e veçanërisht nga traditat shtetërore juridike të Republikës së Krushevës dhe vendimeve historike të KAÇKM-së dhe kontinuitetit kushtetues juridik të shtetit maqedonas si Republikë sovranë në Federatën Jugosllave, nga vullneti lirisht i shprehur i qytetarëve të Republikës së Maqedonisë në Referendumin e 8 shtatorit 1991, si dhe nga fakti historik se Maqedonia është konstituuar si shtet nacional i popullit maqedonas në të cilin sigurohet barazia e plotë qytetare dhe bashkëjetesa e përhershme e popullit maqedonas me shqiptarët, turqit, vllahët, romët dhe kombësitë e tjera që jetojnë në Republikën e Maqedonisë,

e me qëllim që:

- Republika e Maqedonisë të konstituohet si shtet sovran dhe i pavarur dhe si shtet qytetar dhe demokratik;

- të vendoset dhe ndërtohet sundimi i së drejtës si sistem themelor i pushtetit;

- të garantohen të drejtat e njeriut, liritë qytetare dhe barazia nacionale;

- të sigurohet paqja dhe bashkëjetesa e popullit maqedonas, me kombësitë që jetojnë në Republikën e Maqedonisë, dhe

- të sigurohet drejtësia sociale, mirëqenia ekonomike dhe përparimi i jetës personale dhe të përbashkët,

Kuvendi i Republikës së Maqedonisë, miraton

*) *Preambula e Kushtetutës së Republikës të Maqedonisë, është zëvendësuar me Amendamentin IV të Kushtetutës së Republikës të Maqedonisë.*

AMENDAMENTI IV *)

1. Qytetarët e Republikës së Maqedonisë, populli maqedonas, si dhe qytetarët të cilët jetojnë brenda kufijve të saj të cilët janë pjesë e popullit shqiptar, popullit turk, popullit vllleh, popullit serb, popullit rom, popullit boshnjak e të tjerë, duke e marrë përsipër përgjegjësinë për të tashmen dhe të ardhmen e atdheut të tyre, të vetëdijshëm dhe mirënjohës ndaj paraardhësve të tyre për viktimat dhe përkushtimin e përpjekjeve të tyre dhe luftës për krijimin e shtetit të pavarur dhe sovran të Maqedonisë, dhe përgjegjës para gjeneratave të ardhshme për ruajtjen dhe zhvillimin e të gjithë asaj që është e vlefshme nga trashëgimia e pasur kulturore dhe bashkëjetesa në Maqedoni, të barabartë në të drejtat dhe obligimet e tyre për të mirën e përbashkët – Republikës së Maqedonisë - në përputhje me traditën e Republikës së Krushevës dhe vendimet e KAÇKM-së dhe të Referendumit të 8 shtatorit të vitit 1991, vendosën ta konstitudojnë Republikën e Maqedonisë si shtet të pavarur, sovran, me qëllim që të vendoset dhe forcohet sundimi i së drejtës, që të garantohen të drejtat e njeriut dhe liritë qytetare, të sigurohet paqja dhe bashkëjetesa, drejtësia sociale, mirëqenia ekonomike dhe përparimi i jetës individuale dhe të përbashkët, nëpërmjet përfaqësuesve të tyre në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë, të zgjedhur në zgjedhjet e lira dhe demokratike, e nxjerrin këtë:

2. Me pikën 1 të këtij Amendamenti, zëvendësohet Preambula e Kushtetutës së Republikës të Maqedonisë.

**) Preambula – Amendamenti IV është zëvendësuar me Amendamentin XXXIV të Kushtetutës së Republikës të Maqedonisë.*

AMENDAMENTI XXXIV

1. Në Preambulën e Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë shlyhen fjalët: “si dhe qytetarët që jetojnë në kufijtë e saj që janë”, “vendimet e KAÇKM-së” zëvendësohen me fjalët: “vendimet juridike që janë të theksuara në Proklammatën e Mbledhjes së Parë të KAÇKM-së për popullin maqedonas për

mbledhjen e mbajtur të KAÇKM-së". Pas fjalës "vit" shtohen fjalët: "në të cilat u shpreh vullneti për krijimin e shtetit të pavarur sovran dhe Marrëveshjes Kornizë të Ohrit", ndërsa shlyhen fjalët: "vendosën ta".

2. Me këtë amendament bëhen ndryshime në Preambulë – Amendamenti IV i Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë.

K U S H T E T U T A *) **E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË**

AMENDAMENTI XXXIII

1. Në Kushtetutë fjalët: "Republika e Maqedonisë" zëvendësohen me fjalët: "Republika e Maqedonisë së Veriut", ndërsa fjala "Maqedonia" zëvendësohet me fjalët: "Maqedonia e Veriut", përveç në nenin 36 të Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë.

I. DISPOZITA THEMELORE

Neni 1

Republika e Maqedonisë është shtet sovran, i pavarur, demokratik dhe social.

Sovraniteti i Republikës së Maqedonisë është i pandashëm, i patjetërsueshëm dhe i pambartshëm.

Neni 2

Në Republikën e Maqedonisë sovraniteti buron nga qytetarët dhe u takon qytetarëve.

Qytetarët e Republikës së Maqedonisë pushtetin e realizojnë nëpërmjet përfaqësuesve të zgjedhur në mënyrë demokratike, nëpërmjet referendumit dhe formave të tjera të deklarimit të drejtpërdrejtë.

Neni 3 *)

Territori i Republikës së Maqedonisë është i pandashëm dhe i patjetërsueshëm.

Kufiri ekzistues i Republikës së Maqedonisë është i pacenueshëm.

Kufiri i Republikës së Maqedonisë mund të ndryshohet vetëm në përputhje me Kushtetutën.

**) Ky nen është plotësuar me pikën 1 të Amendamentit I të Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë, ndërsa paragrafi 3 është zëvendësuar me pikën 2 të të njëjtit Amendament, ndërsa ky nen është i plotësuar edhe me Amendamentin XXXV..*

**) Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë është botuar në „Gazetën zyrtare të Republikës së Maqedonisë“ numër 52/91, ndërsa amendamentet në „Gazetën zyrtare të Republikës së Maqedonisë“ numër 1/92, 31/98, 91/2001, 84/2003, 107/2005, 3/2009, 49/2011 dhe 6/2019*

AMENDAMENTI I

1. Republika e Maqedonisë nuk ka pretendime territoriale ndaj shteteve fqinje.

2. Kufiri i Republikës së Maqedonisë mund të ndryshohet vetëm në përputhje me Kushtetutën, e në bazë të parimit të vullnetarizmit dhe në përputhje me normat përgjithësisht të pranuar ndërkombëtare.

3. Me pikën 1 të këtij amendamenti plotësohet neni 3, ndërsa me pikën 2 zëvendësohet paragrafi 3 i nenit 3 të Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë.

AMENDAMENTI XXXV

1. Republika e respekton sovranitetin, integritetin territorial dhe pavarësinë politike të shteteve fqinje.

2. Me këtë amendament plotësohet neni 3 i Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë.

Neni 4^{*)}

Qytetarët e Republikës së Maqedonisë kanë shtetësi të Republikës së Maqedonisë.

Shtetasit të Republikës së Maqedonisë nuk mund t'i hiqet shtetësia, as të dëbohet ose t'i dorëzohet shtetët tjetër.

Shtetësia e Republikës së Maqedonisë rregullohet me ligj.

**) Paragrafi 2 i këtij neni është zëvendësuar me Amendamentin XXXII të Kushtetutës së Republikës të Maqedonisë.*

AMENDAMENTI XXXII

1. Shtetasit të Republikës së Maqedonisë nuk mund t'i hiqet shtetësia, as nuk mund të dëbohet nga Republika e Maqedonisë. Shtetasi i Republikës së Maqedonisë nuk mund t'i dorëzohet shtetit tjetër, përveçse në bazë të Marrëveshjes së ratifikuar ndërkombëtare, me vendim gjyqësor.

2. Me këtë amendament zëvendësohet paragrafi 2 i nenit 4 të Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë.

Neni 5

Simbolet shtetërore të Republikës së Maqedonisë janë: stema, flamuri dhe himni.

Stema, flamuri dhe himni i Republikës së Maqedonisë përcaktohen me ligj, i cili nxirret me shumicë prej dy të tretave të votave nga numri i përgjithshëm i deputetëve.

Neni 6

Kryeqyteti i Republikës së Maqedonisë është Shkupi.

Neni 7*)

Në Republikën e Maqedonisë gjuhë zyrtare është gjuha maqedonase dhe alfabeti i saj cirilik.

Në njësitë e vetadministrimit lokal, në të cilat si shumicë jetojnë pjesëtarët e kombësive, në përdorim zyrtar krahas gjuhës maqedonase dhe alfabetit cirilik, janë edhe gjuha dhe alfabeti i kombësive në mënyrë të përcaktuar me ligj.

Në njësitë e vetadministrimit lokal, në të cilat në numër të konsiderueshëm jetojnë pjesëtarët e kombësive, në përdorim zyrtar krahas gjuhës maqedonase dhe alfabetit cirilik, janë edhe gjuha dhe alfabeti i kombësive, në kushte dhe në mënyrë të përcaktuara me ligj.

**) Ky nen është zëvendësuar me Amendamentin V të Kushtetutës së Republikës të Maqedonisë.*

A M E N D A M E N T I V

1. Në tërë territorin e Republikës së Maqedonisë dhe në marrëdhëniet e saj ndërkombëtare, gjuhë zyrtare është gjuha maqedonase dhe alfabeti i saj cirilik.

Gjuhë tjetër që e flasin së paku 20% e qytetarëve, gjithashtu, është gjuhë zyrtare dhe alfabeti i saj, siç është përcaktuar me këtë nen.

Dokumentet personale të qytetarëve, të cilët flasin gjuhë zyrtare të ndryshme nga gjuha maqedonase, lëshohen në gjuhën maqedonase dhe alfabetin e saj, si dhe në atë gjuhë dhe alfabetin e saj në përputhje me ligjin.

Cilido qytetar i cili jeton në njësitë e vetadministrimit lokal, në të cilën së paku 20% e qytetarëve flasin gjuhë zyrtare të ndryshme nga gjuha maqedonase, në komunikim me njësitë rajonale të ministrive, mund ta përdorë cilëndo nga gjuhët zyrtare dhe alfabetin e saj. Njësitë rajonale kompetente për ato njësi të vetadministrimit lokal, përgjigjen në gjuhën maqedonase dhe alfabetin e saj cirilik, si dhe në gjuhën zyrtare dhe alfabetin të cilin e përdor qytetari. Çdo qytetar në komunikim me ministrinë, mund ta përdorë njërën nga gjuhët zyrtare dhe alfabetin e saj, ndërsa ministrinë përgjigjen në gjuhën maqedonase dhe alfabetin e saj cirilik, si dhe në gjuhën zyrtare dhe alfabetin të cilin e përdor qytetari.

Në organet e pushtetit shtetëror në Republikën e Maqedonisë, gjuha zyrtare e ndryshme nga gjuha maqedonase, mund të përdoret në përputhje me ligjin.

Në njësitë e vetadministrimit lokal gjuha dhe alfabeti që e përdorin së paku 20% e qytetarëve është gjuhë zyrtare, krahas gjuhës maqedonase dhe alfabetit të saj cirilik. Për përdorimin e gjuhëve dhe alfabeve, në të cilat flasin së paku 20% e qytetarëve në njësitë e vetadministrimit lokal, vendosin organet e njësive të vetadministrimit lokal.

2. Me këtë amendament zëvendësohet neni 7 i Kushtetutës së Republikës të Maqedonisë.

Neni 8*)

Vlerat themelore të rendit kushtetues të Republikës së Maqedonisë janë:

- liritë dhe të drejtat themelore të njeriut dhe të qytetarit, të njohura me të drejtën ndërkombëtare dhe të përcaktuara me Kushtetutë;
- të shprehurit e lirë të përkatësisë kombëtare;
- sundimi i së drejtës;
- ndarja e pushtetit shtetëror në ligjvënës, ekzekutiv dhe gjyqësor;
- pluralizmi politik dhe zgjedhjet e lira, të drejtpërdrejta dhe demokratike;
- mbrojtja juridike e pronësisë;
- liria e tregut dhe e sipërmarrësisë;
- humanizmi, drejtësia sociale dhe solidariteti;
- vetadministrimi lokal;
- rregullimi dhe humanizimi i hapësirës dhe mbrojtja dhe përparimi i mjedisit jetësor dhe i natyrës dhe
- respektimi i normave përgjithësisht të pranura të së drejtës ndërkombëtare.

Në Republikën e Maqedonisë është e lirë çdo gjë, që nuk është e ndaluar me Kushtetutë dhe me ligj.

**) Alineja 2 e këtij neni, është plotësuar me Amendamentin VI të Kushtetutës së Republikës të Maqedonisë.*

A M E N D A M E N T I VI

1. Përfaqësimi adekuat dhe i drejtë i qytetarëve, të cilët u takojnë të gjitha bashkësive, në organet e pushtetit shtetërorë dhe institucionet e tjera publike në të gjitha nivelet.

2. Me pikën 1 të këtij amendamenti, plotësohet alineja 2 e nenit 8 të Kushtetutës së Republikës të Maqedonisë.

II. LIRITË DHE TË DREJTAT THEMELORE TË NJERIUT DHE TË QYTETARIT

1. Liritë dhe të drejtat civile dhe politike

Neni 9

Qytetarët e Republikës së Maqedonisë janë të barabartë në liritë dhe të drejtat pavarësisht nga gjinia, raca, ngjyra e lëkurës, prejardhja kombëtare dhe sociale, bindja politike dhe fetare, pozita pronësore dhe shoqërore.

Qytetarët janë të barabartë para Kushtetutës dhe ligjeve.

Neni 10

Jeta e njeriut është e pacenueshme.

Në Republikën e Maqedonisë nuk mund të shqiptohet dënimi me vdekje sipas asnjë baze.

Neni 11

Integriteti fizik dhe moral i njeriut janë të pacenueshëm.

Ndalohej çdo formë e torturës, e sjelljes dhe e dënimit çnjerëzor dhe poshtërues.

Ndalohej puna me detyrim.

Neni 12^{*)}

Liria e njeriut është e pacenueshme.

Askujt nuk mund t'i kufizohet liria, përveçse me vendim të gjykatës dhe në raste e në procedurë të përcaktuar me ligj.

Personi i thirrur, i arrestuar ose i privuar nga liria duhet medoemos menjëherë të njoftohet me shkaqet për thirrjen, arrestimin ose privimin e tij nga liria dhe me të drejtat e tij të caktuara me ligj, dhe prej tij nuk mund të kërkohet deklaratë. Personi ka të drejtë në mbrojtës në procedurën policore dhe gjyqësore.

Personi i privuar nga liria duhet medoemos menjëherë, e më së voni në afat prej 24 orësh nga momenti i privimit nga liria, të nxirret para gjykatës, e cila pa shtyrje do të vendosë për ligjshmërinë e privimit nga liria.

Paraburgimi mund të zgjasë me vendim të gjyqit, më së shumti 90 ditë nga dita e paraburgimit.

Personi i paraburgosur, në kushte të caktuara me ligj, mund të lëshohet të mbrohet nga liria.

**) Paragrafi 5 i këtij neni, është zëvendësuar me Amendamentin III të Kushtetutës së Republikës të Maqedonisë.*

A M E N D A M E N T I III

1. Paraburgimi, deri në ngritjen e akuzës, me vendim të gjykatës mund të zgjasë më së shumti 180 ditë nga dita e paraburgimit.

Pas ngritjes së akuzës, paraburgimin e vazhdon ose e përcakton gjykata kompetente në rastin dhe me procedurë të përcaktuar me ligj.

2. Me këtë amendament zëvendësohet paragrafi 5 i nenit 12, të Kushtetutës së Republikës të Maqedonisë.

Neni 13^{*)}

Personi i akuzuar për vepër penale, do të konsiderohet i pafajshëm derisa fajësia e tij nuk do të vërtetohet me vendim të plotfuqishëm gjyqësor.

Personi i privuar nga liria, i paraburgosur në mënyrë të paligjshme, ose i dënuar në mënyrë të paligjshme, ka të drejtën e kompensimit të dëmit dhe të drejta të tjera të përcaktuara me ligj.

**) Ky nen është plotësuar me Amendamentin XX të Kushtetutës së Republikës të Maqedonisë.*

A M E N D A M E N T I XX

1. Për kundërvajtje të përcaktuara me ligj, sanksion mund të shqiptojë organi i administratës shtetërore ose organizata dhe organi tjetër që kryen autorizime publike.

Kundër vendimit të formës së prerë për kundërvajtje, garantohet mbrojtja gjyqësore në kushte dhe në procedurë të rregulluar me ligj.

2. Me këtë amendament plotësohet neni 13 i Kushtetutës së Republikës të Maqedonisë.

Neni 14

Askush nuk mund të dënohet për vepër e cila para se të jetë kryer nuk ka qenë e përcaktuar me ligj ose me normë tjetër si vepër penale, dhe për të cilën nuk ka qenë i parashikuar dënim.

Askush nuk mund të gjykohet sërish për vepër për të cilën ka qenë i dënuar një herë, dhe për të cilën është marrë vendim i plotfuqishëm gjyqësor.

Neni 15^{*)}

Garantohet e drejta e ankesës kundër akteve të veçanta juridike, të miratuara në procedurën e shkallës së parë para gjykatës, organit administrativ apo organizatës ose institucioneve të tjera që kryejnë autorizime publike.

**) Ky nen është zëvendësuar me Amendamentin XXI të Kushtetutës së Republikës të Maqedonisë.*

A M E N D A M E N T I XXI

1. Garantohet e drejta e ankesës kundër vendimeve të miratuara në procedurë të shkallës së parë para gjykatës.

E drejta e ankesës ose lloji tjetër i mbrojtjes juridike kundër akteve juridike të veçanta, të nxjerra në procedurë të shkallës së parë para organit të administratës shtetërore, ose organizatës dhe organit tjetër që kryen autorizime publike, rregullohet me ligj.

2. Me këtë amendament zëvendësohet neni 15 i Kushtetutës së Republikës të Maqedonisë.

Neni 16

Garantohet liria e bindjes, ndërgjegjes, mendimit dhe e shprehjes publike të mendimit.

Garantohet liria e fjalës, paraqitjes publike, informimit publik dhe e themelimit të lirë të institucioneve për informim publik.

Garantohet qasja e lirë tek informatat, liria e pranimit dhe e bartjes së informatave.

Garantohet e drejta e përgjigjes në mjetet e informimit publik.

Garantohet e drejta e korrigjimit në mjetet e informimit publik.

Garantohet e drejta e mbrojtjes së burimit të informatës në mjetet e informimit publik.
Censura është e ndaluar.

Neni 17^{*)}

Garantohet liria dhe fshehtësia e letrave dhe të gjitha formave të tjera të kumtimit.

Vetëm në bazë të vendimit gjyqësor, mund të shmanget nga parimi i pacenueshmërisë së fshehtësisë së letrave, nëse ajo është e domosdoshme për mbajtjen e procedurës penale ose atë e kërkojnë interesat e mbrojtjes së Republikës.

**) Ky nen është zëvendësuar me Amendamentin XIX të Kushtetutës së Republikës të Maqedonisë.*

A M E N D A M E N T I XIX

1. Garantohet liria dhe pacenueshmëria e letrave dhe e të gjitha formave të tjera të komunikimit.

Vetëm në bazë të vendimit të gjykatës, në kushte dhe në procedurë të përcaktuara me ligj, mund të bëhet përjashtim nga e drejta e pacenueshmërisë së letrave dhe të gjitha formave të tjera të komunikimit, nëse kjo është e domosdoshme me qëllim të pengimit ose zbulimit të veprave penale, me qëllim të zhvillimit të procedurës penale ose kur atë e kërkojnë interesat e sigurisë dhe të mbrojtjes së Republikës.

Ligji nxirret me shumicën e dy të tretave të votave të numrit të përgjithshëm të deputetëve.

2. Me këtë amendament zëvendësohet neni 17 i Kushtetutës së Republikës të Maqedonisë.

Neni 18

Garantohen siguria dhe fshehtësia e të dhënave personale.

Qytetarëve u garantohej mbrojtja nga cenimi i integritetit personal, që buron nga regjistrimi i informatave për ta nëpërmjet të përpunimit të të dhënave.

Neni 19^{*)}

Garantohej liria e besimit fetar.

Garantohej shprehja e lirë dhe publike e fesë, individualisht ose në bashkësi me të tjerët.

Kisha Ortodokse Maqedonase, bashkësitë e tjera fetare dhe grupet religjioze janë të ndara nga shteti dhe janë të barabarta para ligjit.

Kisha Ortodokse Maqedonase, bashkësitë e tjera fetare dhe grupet religjioze janë të lira në themelimin e shkollave fetare dhe enteve bamirëse dhe sociale, në procedurë të parashikuar me ligj.

**) Paragrafi 3 i këtij neni është zëvendësuar me pikën 1 të Amendamentit VII të Kushtetutës së Republikës të Maqedonisë, ndërsa paragrafi 4 është zëvendësuar me pikën 2 të të njëjtit Amendament.*

A M E N D A M E N T I V I I

1. Kisha Ortodokse Maqedonase, si dhe Bashkësia Fetare Islame në Maqedoni, Kisha Katolike, Kisha Evangjeliste-Methodiste, Bashkësia Hebraike dhe bashkësitë e tjera fetare dhe grupet religjioze, janë të ndara nga shteti dhe janë të barabarta para ligjit.

2. Kisha Ortodokse Maqedonase, si dhe Bashkësia Fetare Islame në Maqedoni, Kisha Katolike, Kisha Evangjeliste-Methodiste, Bashkësia Hebraike dhe bashkësitë e tjera fetare dhe grupet religjioze, janë të lira në themelimin e shkollave fetare dhe enteve bamirëse dhe sociale në procedurë të parashikuar me ligj.

3. Me pikën 1 të këtij amendamenti zëvendësohet paragrafi 3 i nenit 19, ndërsa pika 2 zëvendësohet me paragrafin 4 të nenit 19 të Kushtetutës së Republikës të Maqedonisë.

Neni 20

Qytetarëve u garantohet liria e bashkimit me qëllim të realizimit dhe mbrojtjes së të drejtave dhe bindjeve të tyre politike, ekonomike, sociale, kulturore dhe të drejtave dhe bindjeve të tjera.

Qytetarët mundën lirisht të themelojnë shoqata civile dhe parti politike, të aderojnë dhe të dalin nga ato.

Programet dhe veprimtaria e shoqatave civile dhe partive politike nuk mund të orientohen drejt rrënimit të dhunshëm të rendit kushtetues të Republikës dhe drejt nxitjes ose thirrjes së agresionit ushtarak, ose nxitjes së urrejtjes ose mosdurimit kombëtar, racor ose fetar.

Ndalohen shoqatat ushtarake ose gjysmëushtarake, të cilat nuk u takojnë forcave të armatosura të Republikës së Maqedonisë.

Neni 21

Qytetarët kanë të drejtë në mënyrë të qetë të tubohen dhe të shprehin protestë publike, pa paraqitje paraprake dhe pa leje të posaçme.

Shfrytëzimi i kësaj të drejte mund të kufizohet vetëm në kushte të gjendjes së luftës dhe të gjendjes së jashtëzakonshme.

Neni 22

Çdo qytetar që ka mbushur 18 vjet e fiton të drejtën e zgjedhjes.

E drejta e zgjedhjes është e barabartë, e përgjithshme dhe e drejtpërdrejtë dhe realizohet në zgjedhje të lira me votim të fshehtë.

Të drejtë zgjedhjeje nuk kanë personat të cilëve u është hequr aftësia e veprimit.

Neni 23

Çdo qytetar ka të drejtë të marrë pjesë në ushtrimin e funksioneve publike.

Neni 24

Çdo qytetar ka të drejtë të parashtrojë parashtresa në organet shtetërore dhe shërbimet e tjera publike dhe për ato të marrë përgjigje.

Qytetari nuk mund të thirret në përgjegjësi, as të pësojë pasoja të dëmshme për qëndrimet e paraqitura në parashtresa, përveç nëse me to nuk ka kryer vepër penale.

Neni 25

Çdo qytetari i garantohet respektimi dhe mbrojtja e privatësisë së jetës të tij personale dhe familjare, e dinjitetit dhe e autoritetit.

Neni 26

Garantohet paprekshmëria e shtëpisë.

E drejta e paprekshmërisë së shtëpisë mund të kufizohet vetëm me vendim gjyqësor, kur është në pyetje zbulimi ose pengimi i veprave penale ose mbrojtja e shëndetit të njerëzve.

Neni 27

Çdo qytetar i Republikës së Maqedonisë ka të drejtë që të lëvizë lirisht në territorin e Republikës dhe lirisht ta zgjedhë vendbanimin e tij.

Çdo qytetar ka të drejtë ta lëshojë territorin e Republikës dhe të kthehet në Republikë.

Realizimi i këtyre të drejtave mund të kufizohet me ligj, vetëm në rastet kur kjo është e nevojshme me qëllim të mbrojtjes së sigurisë të Republikës, zhvillimit të procedurës penale ose mbrojtjes së shëndetit të njerëzve.

Neni 28

Mbrojtja e Republikës së Maqedonisë është e drejtë dhe detyrë e çdo qytetari.

Realizimi i kësaj të drejte dhe detyre të qytetarëve rregullohet me ligj.

Neni 29

Të huajt në Republikën e Maqedonisë i gëzojnë liritë dhe të drejtat e garantuara me Kushtetutë, me kushte të përcaktuara me ligj dhe me marrëveshje ndërkombëtare.

Republika ua garanton të drejtën e azilit të huajve dhe personave pa shtetësi, të përndjekur për shkak të bindjeve dhe veprimeve politike demokratike.

Ekstradimi i të huajit mund të bëhet vetëm në bazë të marrëveshjes ndërkombëtare të ratifikuar dhe në bazë të parimit të reciprocitetit. I huaji nuk mund të ekstradohet për shkak të veprës penale politike. Veprimet e terrorizmit nuk konsiderohen vepra penale politike.

2. Të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore

Neni 30

Garantohet e drejta e pronësisë dhe e drejta e trashëgimisë.

Pronësia krijon të drejta dhe obligime dhe duhet të shërbejë për të mirën e individit dhe të bashkësisë.

Askujt nuk mund t'i merret ose t'i kufizohet pronësia dhe të drejtat të cilat rrjedhin prej saj, përveçse kur kemi të bëjmë me interesin publik të përcaktuar me ligj.

Në rast të eksproprijimit të pronësisë ose në rast të kufizimit të pronësisë, garantohet kompensimi i drejtë i cili nuk mund të jetë më i ulët nga vlera e tregut.

Neni 31

Personi i huaj në Republikën e Maqedonisë mund të fitojë të drejtën e pronësisë, në kushtet e përcaktuara me ligj.

Neni 32

Secili ka të drejtë në punë, zgjedhje të lirë të punësimit, mbrojtje gjatë punës dhe në sigurim material gjatë kohës të papunësisë së përkohshme.

Secili, në kushte të barabarta, e ka të arritshëm çdo vend pune.

Secili i punësuar ka të drejtë në përfitim përkatës.

Secili i punësuar ka të drejtë në pushim të paguar ditor, javor dhe vjetor. Të punësuarit nuk mund të heqin dorë nga këto të drejta.

Realizimi i të drejtave të të punësuarve dhe pozita e tyre, rregullohen me ligj dhe me marrëveshje kolektive.

Neni 33

Secili e ka për detyrë të paguajë tatim dhe detyrime të tjera publike dhe të marrë pjesë në përmbushjen e shpenzimeve publike në mënyrë të përcaktuar me ligj.

Neni 34

Qytetarët kanë të drejtë në siguri sociale dhe sigurim social të përcaktuara me ligj dhe me marrëveshje kolektive.

Neni 35

Republika kujdeset për mbrojtjen sociale dhe sigurinë sociale të qytetarëve në pajtim me parimin e drejtësisë sociale.

Republika ua garanton të drejtën e ndihmës qytetarëve të pafuqishëm dhe të paaftë për punë.

Republika u siguron mbrojtje të veçantë invalidëve dhe kushte për inkuadrimin e tyre në jetën shoqërore.

Neni 36

Republika u garanton të drejta të veçanta sociale luftëtarëve të Luftës Antifashiste dhe nga të gjitha luftërat nacional-çlirimtare të

Maqedonisë, invalidëve të luftës, të përndjekurve dhe të burgosurve për idetë e vetëqenies së popullit maqedonas dhe shtetformimit të tij, si dhe anëtarëve të familjeve të tyre të cilët nuk kanë mundësi për ekzistencë materiale dhe sociale.

Të drejtat e veçanta rregullohen me ligj.

Neni 37

Me qëllim të realizimit të të drejtave të tyre ekonomike dhe sociale, qytetarët kanë të drejtë të themelojnë sindikata. Sindikatat mund të themelojnë shoqata të tyre dhe të aderojnë në organizata sindikale ndërkombëtare.

Me ligj mund të kufizohen kushtet për realizimin e të drejtës së organizimit sindikal në forcat e armatosura, në polici dhe në organet e administratës.

Neni 38

Garantohet e drejta e grevës.

Me ligj mund të kufizohen kushtet për realizimin e të drejtës së grevës në forcat e armatosura, në polici dhe në organet e administratës.

Neni 39

Secilit qytetar i garantohet e drejta e mbrojtjes shëndetësore.

Qytetari ka të drejtë dhe detyrë që të ruajë dhe ta përparojë shëndetin e tij dhe shëndetin e të tjerëve.

Neni 40

Republika i siguron kujdes dhe mbrojtje të veçantë familjes.

Marrëdhëniet juridike në martesë, familje dhe bashkësinë jashtëmartesore rregullohen me ligj.

Prindërit kanë të drejtë dhe detyrë që të kujdesen për mbajtjen dhe edukimin e fëmijëve. Fëmijët e kanë për detyrë që të kujdesen për prindërit e moshuar dhe të pamundur.

Republika u siguron mbrojtje të veçantë fëmijëve pa prindër dhe fëmijëve pa kujdes prindëror.

Neni 41

Është e drejtë e njeriut që lirisht të vendosë për të pasur fëmijë.

Republika, me qëllim të zhvillimit të harmonizuar ekonomik dhe social, udhëheq një politikë humane të popullimit.

Neni 42

Republika veçanërisht i mbron amësinë, fëmijët dhe personat e mitur.

Personi më i ri se 15 vjet nuk mund të punësohet.

Personat e mitur dhe nënat kanë të drejtë në mbrojtje të veçantë gjatë punës.

Personat e mitur nuk guxojnë të punësohen në vendet e punës, të cilat janë të dëmshme për shëndetin dhe moralin e tyre.

Neni 43

Secili njeri ka të drejtë për mjedis të shëndetshëm jetësor.

Secili e ka për detyrë ta përparojë dhe ta mbrojë mjedisin jetësor dhe natyrën.

Republika siguron kushte për realizimin e të drejtës së qytetarëve për mjedis të shëndetshëm jetësor.

Neni 44

Secili ka të drejtë në arsimim.

Arsimimi është i arritshëm për secilin në kushte të barabarta.

Arsimimi fillor është i detyrueshëm dhe pa pagesë.

Neni 45

Qytetarët kanë të drejtë, në kushtet e përcaktuara me ligj, të themelojnë institucione private të arsimit në të gjitha shkallët e arsimit, përveçse në arsimin fillor.

Neni 46

Universitetit i garantohet autonomia.

Kushtet për themelimin, ushtrimin dhe shuarjen e veprimtarisë së universitetit, rregullohen me ligj.

Neni 47

Garantohet liria e krijimtarisë shkencore, artistike dhe llojet e tjera të krijimtarisë.

Garantohen të drejtat të cilat rrjedhin nga krijimtaria shkencore, artistike ose nga lloji tjetër i krijimtarisë intelektuale.

Republika e nxit, ndihmon dhe mbron zhvillimin e shkencës, artit dhe kulturës.

Republika e nxit dhe ndihmon zhvillimin shkencor dhe teknologjik.

Republika e nxit dhe ndihmon kulturën teknike dhe sportin.

Neni 48^{*)}

Pjesëtarët e kombësive kanë të drejtë që lirisht t'i shprehin, kultivojnë dhe zhvillojnë identitetin e tyre dhe veçoritë nacionale.

Republika ua garanton kombësive mbrojtjen e identitetit etnik, kulturor, gjuhësor dhe fetar.

Pjesëtarët e kombësive kanë të drejtë të themelojnë institucione kulturore dhe artistike, shoqata shkencore dhe shoqata të tjera me qëllim të shprehjes, kultivimit dhe zhvillimit të identitetit të tyre.

Pjesëtarët e kombësive kanë të drejtë në mësim në gjuhën e tyre në arsimin fillor dhe të mesëm, në mënyrën e përcaktuar me ligj. Në shkollat në të cilat arsimimi zhvillohet në gjuhën e kombësisë, mësohet edhe gjuha maqedonase.

**) Ky nen është zëvendësuar me Amendamentin VIII të Kushtetutës së Republikës të Maqedonisë.*

A M E N D A M E N T I VIII

1. Pjesëtarët e bashkësive kanë të drejtë lirisht ta shprehin, kultivojnë dhe zhvillojnë identitetin dhe veçoritë e bashkësive të tyre dhe t'i përdorin simbolet e bashkësisë së tyre.

Republika ua garanton të gjitha bashkësive mbrojtjen e identitetit etnik, kulturor, gjuhësor dhe fetar.

Pjesëtarët e bashkësive kanë të drejtë të themelojnë institucione kulturore, artistike, arsimore, si dhe shoqata shkencore dhe shoqata të tjera me qëllim të shprehjes, kultivimit dhe zhvillimit të identitetit të tyre.

Pjesëtarët e bashkësive kanë të drejtë të ndjekin mësimin në gjuhën e tyre në arsimin fillor dhe të mesëm, në mënyrë të përcaktuar me ligj. Në shkollat në të cilat arsimimi zhvillohet në gjuhë tjetër, mësohet edhe gjuha maqedonase.

2. Me këtë amendament zëvendësohet neni 48 i Kushtetutës së Republikës të Maqedonisë.

Neni 49^{*)}

Republika kujdeset për pozitën dhe të drejtat e pjesëtarëve të popullit maqedonas në shtetet fqinje dhe për emigrantët nga Maqedonia, e ndihmon zhvillimin e tyre kulturor dhe i përparon lidhjet me ta.

Republika kujdeset për të drejtat kulturore, ekonomike dhe sociale të qytetarëve të Republikës jashtë vendit.

**) Ky nen paragrafi 1 i të cilit u plotësua me Amendamentin II të Kushtetutës së Republikës të Maqedonisë është zëvendësuar me Amendamentin XXXVI të Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë.*

AMENDAMENTI XXXVI

1. Republika i mbron, garanton dhe kultivon veçoritë, trashëgiminë historike dhe kulturore të popullit maqedonas.

Republika i mbron të drejtat dhe interesat e shtetasve të vet të cilët jetojnë ose qëndrojnë jashtë vendit.

Republika kujdeset për diasporën e popullit maqedonas dhe për një pjesë të popullit shqiptar, popullit turk, popullit vllleh, popullit serb, popullit rom, popullit boshnjak, etj., dhe i kultivon dhe i avancoon lidhjet me atdheun.

Republika me këtë rast nuk do të përzihet në të drejtat sovraane të shteteve tjera dhe në punët e tyre të brendshme.

2. Me këtë amendament zëvendësohet neni 49 dhe Amendamenti II i Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë.

3. Garancitë e lirive dhe të drejtave themelore

Neni 50

Çdo qytetar mund të thirret në mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të përcaktuara me Kushtetutë, para gjykatave dhe para Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Maqedonisë, në procedurë të mbështetur mbi parimet e prioritetit dhe urgjencës.

Garantohet mbrojtja gjyqësore e ligjshmërisë së akteve të veçanta të administratës shtetërore dhe të institucioneve të tjera që ushtrojnë autorizime publike.

Qytetari ka të drejtë të njoftohet me të drejtat dhe liritë themelore të njeriut dhe në mënyrë aktive të kontribuojë, individualisht ose bashkë me të tjerët, për përparimin dhe mbrojtjen e tyre.

Neni 51

Në Republikën e Maqedonisë ligjet medoemos duhet të jenë në përputhje me Kushtetutën, ndërsa të gjitha aktet e tjera normative me Kushtetutën dhe me ligjin.

Secili e ka për detyrë ta respektojë Kushtetutën dhe ligjet.

Neni 52

Ligjet dhe rregullat e tjera shpallen para se të hyjnë në fuqi.

Ligjet dhe rregullat e tjera shpallen në “Gazetën zyrtare të Republikës së Maqedonisë”, më së voni brenda afatit prej shtatë ditësh nga dita e nxjerrjes së tyre.

Ligjet hyjnë në fuqi jo më herët se ditën e tetë nga dita e shpalljes, me përjashtim, të cilin e përcakton Kuvendi, në ditën e shpalljes.

Ligjet dhe rregullat e tjera nuk mund të kenë efekt prapaveprues, përveç përjashtimit, në rastet kur kjo është më e favorshme për qytetarët.

Neni 53

Avokatura është shërbim publik i mëvetësishëm dhe i pavarur, që siguron ndihmë juridike dhe ushtron autorizime publike në pajtim me ligjin.

Neni 54

Liritë dhe të drejtat e njeriut e të qytetarit mund të kufizohen vetëm në rastet e përcaktuara me Kushtetutë.

Liritë dhe të drejtat e njeriut e të qytetarit mund të kufizohen gjatë kohës së gjendjes së luftës ose gjendjes së jashtëzakonshme sipas dispozitave të Kushtetutës.

Kufizimi i lirive dhe të drejtave nuk mund të jetë diskriminues në bazë të gjinisë, racës, ngjyrës së lëkurës, gjuhës, fesë, prejardhjes kombëtare ose sociale, pozitës pronësore ose shoqërore.

Kufizimi i lirive dhe të drejtave nuk mund të përfshijë të drejtën e jetës, ndalimin e torturës, veprimin dhe ndëshkimin çnjerëzor dhe nënçmues, përcaktimin juridik të veprave të ndëshkueshme dhe

dënimeve, si dhe lirinë e bindjes, ndërgjegjes, mendimit, shprehjes publike të mendimit dhe të besimit fetar.

4. Bazat e marrëdhënieve ekonomike

Neni 55

Garantohet liria e tregut dhe e sipërmarrësisë.

Republika u siguron pozitë të barabartë juridike të gjitha subjekteve në treg. Republika ndërmerr masa kundër pozitës monopoliste dhe sjelljes monopoliste në treg.

Liria e tregut dhe e sipërmarrësisë mund të kufizohen me ligj vetëm me qëllim të mbrojtjes së Republikës, ruajtjes së natyrës, mjedisit jetësor ose shëndetit të njerëzve.

Neni 56^{*)}

Të gjitha pasuritë natyrore të Republikës, bota bimore dhe shtazore, të mirat në përdorim të përgjithshëm, si dhe sendet dhe objektet me rëndësi të veçantë kulturore dhe historike të përcaktuara me ligj, janë të mira me interes të përgjithshëm për Republikën dhe gëzojnë mbrojtje të veçantë.

Republika e garanton mbrojtjen, përparimin dhe pasurimin e thesarit historik dhe artistik të popullit maqedonas dhe të kombësive, si dhe të mirave që e përbëjnë atë, pa marrë parasysh regjimin e tyre juridik.

Me ligj rregullohen mënyra dhe kushtet në të cilat të mirat e caktuara me interes të përgjithshëm për Republikën, mund të jepen në shfrytëzim.

**) Paragrafi 2 i këtij neni është zëvendësuar me Amendamentin IX të Kushtetutës së Republikës të Maqedonisë.*

A M E N D A M E N T I IX

1. Republika e garanton mbrojtjen, përparimin dhe pasurimin e thesarit historik dhe artistik të Maqedonisë dhe të të

gjitha bashkësive në Maqedoni, si dhe të mirave që e përbëjnë atë, pa marrë parasysh regjimin e tyre juridik.

2. Me pikën 1 të këtij amendamenti zëvendësohet paragrafi 2 i nenit 56 të Kushtetutës së Republikës të Maqedonisë.

Neni 57

Republika e nxit përparimin ekonomik dhe kujdeset për zhvillimin më të balancuar hapësinor dhe rajonal, si dhe për zhvillimin më të shpejtë të rajoneve ekonomikisht jo mjaft të zhvilluara.

Neni 58

Pronësia dhe puna janë bazë për udhëheqje dhe pjesëmarrje në vendimmarrje.

Pjesëmarrja në udhëheqje dhe në vendimmarrje në institucionet dhe shërbimet publike, rregullohet me ligj dhe në bazë të parimeve të profesionalizmit dhe kompetencës.

Neni 59

Investitorëve të huaj u garantohet e drejta e nxjerrjes së lirë të kapitalit të investuar dhe të fitimit.

Të drejtat e fituara në bazë të kapitalit të investuar, nuk mund të zvogëlohen me ligj ose me rregull tjetër.

Neni 60

Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë është bankë e emisionit.

Banka Popullore është e pavarur dhe mban përgjegjësi për stabilitetin e valutës, për politikën monetare dhe për likuiditetin e përgjithshëm të pagesave në Republikë dhe ndaj vendeve të jashtme.

Organizimi dhe puna e Bankës Popullore rregullohen me ligj.

III. ORGANIZIMI I PUSHTETIT SHTETËROR

1. Kuvendi i Republikës së Maqedonisë

Neni 61

Kuvendi i Republikës së Maqedonisë është organ përfaqësues i qytetarëve dhe bartës i pushtetit ligjvënës i Republikës.

Organizimi dhe funksionimi i Kuvendit rregullohen me Kushtetutë dhe me Rregulloren e punës.

Neni 62

Kuvendin e përbëjnë 120 deri në 140 deputetë.

Deputetët zgjidhen në zgjedhje të përgjithshme, të drejtpërdrejta dhe të lira me votim të fshehtë.

Deputeti i përfaqëson qytetarët dhe në Kuvend vendos sipas bindjes së tij.

Deputeti nuk mund të revokohet.

Mënyra dhe kushtet për zgjedhjen e deputetëve rregullohen me ligj, i cili nxirret me shumicën e votave nga numri i përgjithshëm i deputetëve.

Neni 63

Deputetët në Kuvend zgjidhen për periudhë kohore prej katër vitesh. Mandatin e deputetëve e verifikon Kuvendi. Mandati fillon të rrjedhë nga seanca konstitutive e Kuvendit. Kuvendi i porsazgjedhur mblidhet në seancën konstitutive më së voni 20 ditë pas zgjedhjeve të mbajtura. Seancën konstitutive e thirr Kryetari i Kuvendit nga përbërja e mëparshme.

Në qoftë se seanca konstituive nuk thirret në afatin e paraparë, deputetët vetë mblidhen dhe e konstituojnë Kuvendin në ditën e njëzetënjëtë nga dita e përfundimit të zgjedhjeve.

Zgjedhjet për deputetë në Kuvend mbahen në 90 ditët e fundit të mandatit të përbërjes së vjetër të deputetëve ose brenda afatit prej 60 ditësh nga dita e shpërndarjes së Kuvendit.

Mandati i deputetëve në Kuvend mund të zgjatet vetëm në rast të luftës ose gjendjes së jashtëzakonshme.

Me ligj caktohet papajtueshmëria dhe pazgjedhshmëria e funksionit të deputetit në Kuvend me ushtrimin e funksioneve ose profesioneve të tjera publike.

Kuvendi shpërndahet nëse për atë deklarohet shumica nga numri i përgjithshëm i deputetëve.

Neni 64

Deputetët gëzojnë imunitet.

Deputeti nuk mund të thërritet në përgjegjësi penale ose të arrestohet për mendimin e shprehur ose për votimin në Kuvend.

Deputeti nuk mund të arrestohet pa pëlqimin e Kuvendit, përveç nëse kapet në kryerje e sipër të veprës penale për të cilën është përcaktuar dënim me burg në kohëzgjatje prej së paku pesë vitesh.

Kuvendi mund të vendos të aplikohet imuniteti mbi deputetin edhe kur ai vetë nuk thirret në të, nëse kjo është e nevojshme me qëllim të ushtrimit të funksionit të deputetit.

Gjatë kohës së mandatit deputetët nuk i nënshtrohen detyrimit në forcat e armatosura.

Deputeti ka të drejtë në kompensim të përcaktuar me ligj.

Neni 65

Deputeti mund të paraqesë dorëheqje.

Deputeti dorëheqjen e paraqet personalisht në seancën e Kuvendit.

Deputetit i pushon mandati kur është dënuar për vepër penale për të cilën është përcaktuar dënim me burg në kohëzgjatje prej së paku pesë vitesh.

Deputetit mund t'i hiqet mandati kur është dënuar për vepër penale ose vepër tjetër të ndëshkueshme e cila e bën të padenjë për ta ushtruar funksionin e deputetit, si dhe kur mungon pa arsye për më tepër se gjashtë muaj në Kuvend. Heqjen e mandatit e bën Kuvendi

me shumicë prej dy të tretave të votave nga numri i përgjithshëm i deputetëve.

Neni 66

Kuvendi është në punime të përhershme.

Kuvendi punon në seanca.

Seancat e Kuvendit i thërret Kryetari i Kuvendit.

Kuvendi nxjerr Rregulloren e punës me shumicën e votave të numrit të përgjithshëm të deputetëve.

Neni 67

Kuvendi nga radha e deputetëve e zgjedh Kryetarin dhe një ose më shumë nënkryetarë, me shumicën e votave nga numri i përgjithshëm i deputetëve.

Kryetari i Kuvendit e përfaqëson Kuvendin, kujdeset për zbatimin e Rregullores së punës të Kuvendit dhe ushtron punë të tjera të përcaktuara me Kushtetutë dhe me Rregulloren e punës së Kuvendit.

Funksioni Kryetar i Kuvendit nuk pajtohet me ushtrimin e funksionit, profesionit tjetër publik ose funksionit në parti politike.

Kryetari i Kuvendit i shpall zgjedhjet për deputetë dhe për zgjedhjen e Presidentit të Republikës.

Neni 68^{a)}

Kuvendi i Republikës së Maqedonisë:

- nxjerr dhe ndryshon Kushtetutën;
- nxjerr ligje dhe bën interpretimin autentik të ligjeve;
- i përcakton detyrimet publike;
- nxjerr Buxhetin e Republikës dhe llogarinë përfundimtare të Buxhetit;
- nxjerr planin hapësinor të Republikës;
- ratifikon marrëveshje ndërkombëtare;
- vendos për luftë dhe paqe;
- merr vendim për ndryshimin e kufijve të Republikës;

- merr vendim për aderim dhe dalje nga aleanca ose bashkësia me shtetet e tjera;
- shpall referendum;
- vendos për rezervat e Republikës;
- themelon këshilla;
- zgjedh Qeverinë e Republikës së Maqedonisë;
- zgjedh gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Maqedonisë;
- bën zgjedhjen dhe shkarkimin e gjyqtarëve;
- bën zgjedhjen, emërimin dhe shkarkimin edhe të bartësve të tjerë të funksioneve publike dhe funksioneve të tjera të përcaktuara me Kushtetutë dhe me ligj;
- ushtron kontroll dhe mbikëqyrje politike mbi Qeverinë dhe mbi bartësit e tjerë të funksioneve publike të cilët përgjigjen para Kuvendit;
- jep amnisti, dhe
- kryen punë të tjera të përcaktuara me Kushtetutë.

Kuvendi për kryerjen e punëve nga kompetenca e tij miraton edhe vendime, deklarata, rezoluta, rekomandime dhe konkluzione.

**) Alineja 15 e paragrafit 1 të këtij neni shlyhet me Amendamentin XXIX të Kushtetutës së Republikës të Maqedonisë (shih Nenin 105).*

Neni 69*)

Kuvendi mund të punojë nëse në seancë merr pjesë shumica e numrit të përgjithshëm të deputetëve. Kuvendi vendos me shumicë të votave të deputetëve të pranishëm, ndërsa më së paku me një të tretën nga numri i përgjithshëm i deputetëve, nëse me Kushtetutë nuk është parashikuar shumicë e veçantë.

**) Ky nen është zëvendësuar me Amendamentin X të Kushtetutës së Republikës të Maqedonisë.*

AMENDAMENTI X

1. Kuvendi mund të vendosë nëse në seancë merr pjesë shumica e numrit të përgjithshëm të deputetëve. Kuvendi vendos me shumicën e votave të deputetëve të pranishëm dhe së paku me një të tretën e numrit të përgjithshëm të deputetëve, nëse me Kushtetutë nuk është parashikuar shumicë e veçantë.

2. Për ligjet të cilët drejtpërsëdrejti kanë të bëjnë me kulturën, përdorimin e gjuhëve, arsimin, dokumentet personale dhe përdorimin e simboleve, Kuvendi vendos me shumicën e votave të deputetëve të pranishëm, me ç'rast medoemos duhet të ketë shumicë të votave nga deputetët e pranishëm të cilët u takojnë bashkësive që nuk janë shumicë në Republikën e Maqedonisë. Kontestin në lidhje me zbatimin e kësaj dispozite e zgjidh Komiteti për Marrëdhënie Ndërmjet Bashkësive.

3. Me këtë amendament zëvendësohet neni 69 i Kushtetutës së Republikës të Maqedonisë.

Neni 70

Seancat e Kuvendit janë publike.

Kuvendi mund të vendosë të punojë pa prezencën e publikut me shumicë prej dy të tretave të votave nga numri i përgjithshëm i deputetëve.

Neni 71

Të drejtë për të propozuar nxjerrje të ligjit ka çdo deputet i Kuvendit, Qeveria e Republikës së Maqedonisë dhe së paku 10.000 zgjedhës.

Iniciativë për nxjerrjen e ligjit propozuesve të autorizuar mund t'u paraqesë çdo qytetar, grup qytetarësh, institucione dhe shoqata.

Neni 72

Interpelancë mund të parashtrohet për punën e secilit bartës të funksionit publik, Qeverisë dhe secilit anëtar të saj veç e veç, si dhe për çështjet nga puna e organeve shtetërore.

Interpelancë mund të paraqesin së paku pesë deputetë.

Pyetje deputeti mund të parashtrojë çdo deputet.

Mënyra dhe procedura e paraqitjes dhe e diskutimit, lidhur me interpelancën dhe pyetjen e deputetit, rregullohen me Rregulloren e punës.

Neni 73

Kuvendi vendos për shpalljen e referendumit për çështje të caktuara nga kompetenca e tij me shumicën e votave nga numri i përgjithshëm i deputetëve.

Vendimi në referendum është miratuar, nëse për të ka votuar shumica e zgjedhësve të cilët kanë votuar, në qoftë se kanë votuar më shumë se gjysma e numrit të përgjithshëm të zgjedhësve.

Kuvendi e ka për detyrë të shpallë referendum kur propozim do të paraqesin së paku 150.000 zgjedhës.

Vendimi i miratuar në referendum është i detyrueshëm.

Neni 74

Kuvendi merr vendim për ndryshimin e kufijve të Republikës me shumicë prej dy të tretave të votave nga numri i përgjithshëm i deputetëve.

Vendimi për ndryshimin e kufirit të Republikës është miratuar në referendum, në qoftë se për të ka votuar shumica nga numri i përgjithshëm i zgjedhësve.

Neni 75

Ligjet shpallen me dekret.

Dekretin për shpalljen e ligjeve e nënshkruajnë Presidenti i Republikës dhe Kryetari i Kuvendit.

Presidenti i Republikës mund të vendosë të mos e nënshkruajë dekretin për shpalljen e ligjit. Kuvendi sërish e shqyrton ligjin dhe në qoftë se e miraton me shumicën e votave nga numri i përgjithshëm i deputetëve, Presidenti i Republikës e ka për detyrë ta nënshkruajë dekretin.

Presidenti e ka për detyrë ta nënshkruajë dekretin, në qoftë se sipas Kushtetutës, ligji nxirret me shumicë prej dy të tretave të votave nga numri i përgjithshëm i deputetëve.

Neni 76

Kuvendi themelon trupa punues të përhershëm dhe të përkohshëm.

Kuvendi mund të themelojë komisione anketuese për të gjitha fushat dhe për çdo çështje me interes publik.

Propozim për themelimin e komisionit anketues mund të paraqesin së paku 20 deputetë.

Kuvendi themelon komision të përhershëm anketues për mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të qytetarit.

Të dhënat e komisioneve anketuese janë bazë për iniciimin e procedurës për përcaktimin e përgjegjësisë së bartësve të funksioneve publike.

Neni 77^{*)}

Kuvendi e zgjedh Avokatin e Popullit.

Avokati i Popullit i mbron të drejtat kushtetuese dhe ligjore të qytetarëve të cilat u janë cenuar nga organet e administratës shtetërore dhe nga organet e organizatat e tjera të cilat kanë autorizime publike.

Avokati i Popullit zgjidhet për periudhë kohore prej tetë vitesh, me të drejtë edhe për një zgjedhje.

Kushtet për zgjedhjen dhe shkarkimin, kompetencat dhe mënyra e punës së Avokatit të Popullit rregullohen me ligj.

**) Paragrafi 1 i këtij neni është zëvendësuar me pikën 1 të Amendamentit XI të Kushtetutës së Republikës të Maqedonisë, ndërsa paragrafi 2 është plotësuar me pikën 2 të Amendamentit të njëjtë.*

AMENDAMENTI XI

1. Kuvendi e zgjedh Avokatin e Popullit me shumicën e votave nga numri i përgjithshëm i deputetëve, me ç'rast duhet të ketë shumicë të votave nga numri i përgjithshëm i deputetëve të cilët u takojnë bashkësive që nuk janë shumicë në Republikën e Maqedonisë.

2. Avokati i Popullit i mbron të drejtat kushtetuese dhe ligjore të qytetarëve të cilat u janë cenuar nga organet e administratës shtetërore dhe nga organet e organizatat e tjera të cilat kanë autorizime publike. Avokati i Popullit i përkushton vëmendje të veçantë mbrojtjes së parimeve të mosdiskriminimit, të përfaqësimit adekuat dhe të drejtë të pjesëtarëve të bashkësive në organet e pushtetit shtetëror, organet e njësive të vetadministrimit lokal dhe në institucionet dhe shërbimet publike.

3. Me pikën 1 të këtij amendamenti zëvendësohet paragrafi 1 i nenit 77, ndërsa me pikën 2 plotësohet paragrafi 2 i nenit 77 të Kushtetutës së Republikës të Maqedonisë.

Neni 78^{*)}

Kuvendi themelon Këshill për Marrëdhënie Ndëretnike.

Këshillin e përbëjnë: Kryetari i Kuvendit dhe nga dy anëtarë maqedonas, shqiptarë, turq, vlleh, romë dhe dy anëtarë nga kombësi të tjera në Maqedoni.

Kryetari i Kuvendit është edhe kryetar i Këshillit.

Kuvendi i zgjedh anëtarët e Këshillit.

Këshilli i shqyrton çështjet e marrëdhënieve ndëretnike në Republikë dhe jep mendim dhe propozime për zgjidhjen e tyre.

Kuvendi është i detyruar t'i shqyrtojë mendimet dhe propozimet e Këshillit dhe të merr vendim në lidhje me to.

**) Ky nen është zëvendësuar me Amendamentin XII të Kushtetutës së Republikës të Maqedonisë.*

AMENDAMENTI XII

1. Kuvendi themelon Komitetin për Marrëdhënie Ndërmjet Bashkësive.

Komitetin e përbëjnë 19 anëtarë prej të cilëve nga shtatë anëtarë nga radhët e deputetëve maqedonas dhe shqiptarë të Kuvendit dhe nga një anëtarë nga radhët e deputetëve turq, vllleh, romë, serbë dhe boshnjakë. Në qoftë se ndonjëra nga bashkësitë nuk ka deputet, Avokati i Popullit, pas konsultimeve me përfaqësues relevantë të atyre bashkësive, do t'i propozojë anëtarët e tjerë të Komitetit.

Kuvendi i zgjedh anëtarët e Komitetit.

Komiteti shqyrton çështje nga marrëdhëniet ndërmjet bashkësive në Republikë dhe jep mendime dhe propozime për zgjidhjen e tyre.

Kuvendi detyrimisht duhet t'i shqyrtojë mendimet dhe propozimet e Komitetit dhe të merr vendime lidhur me to.

Në rast të kontestit lidhur me zbatimin e procedurës për votim në Kuvend, të përcaktuar me nenin 69 paragrafin 2, Komiteti vendos me shumicën e votave të anëtarëve, për atë se a do të zbatohet procedura.

2. Me pikën 1 të këtij amendamenti zëvendësohet neni 78 i Kushtetutës së Republikës të Maqedonisë dhe shlyhet alinea 7 e nenit 84 të Kushtetutës së Republikës të Maqedonisë.

2. Presidenti i Republikës së Maqedonisë

Neni 79

Presidenti i Republikës së Maqedonisë e përfaqëson Republikën.

Presidenti i Republikës është komandant suprem i forcave të armatosura të Maqedonisë.

Presidenti i Republikës të drejtat dhe detyrat e veta i ushtron në bazë dhe në kuadër të Kushtetutës dhe ligjeve.

Neni 80

Presidenti i Republikës zgjidhet në zgjedhje të përgjithshme dhe të drejtpërdrejta, me votim të fshehtë, për periudhë kohore prej pesë vitesh.

Për President të Republikës personi i njëjtë mund të zgjidhet më së shumti dy herë.

Presidenti i Republikës doemos duhet të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë.

President i Republikës së Maqedonisë mund të zgjidhet personi i cili në ditën e zgjedhjeve ka mbushur më së paku 40 vjet moshë.

Për President të Republikës nuk mund të zgjidhet personi i cili deri në ditën e zgjedhjeve nuk ka qenë banor i Republikës së Maqedonisë së paku dhjetë vjet në 15 vitet e fundit.

Neni 81^{*)}

Kandidat për President të Republikës mund të propozojnë së paku 10.000 zgjedhës ose së paku 30 deputetë.

Për President të Republikës është zgjedhur kandidati i cili ka fituar shumicën e votave nga numri i përgjithshëm i zgjedhësve.

Nëse në rrethin e parë asnjë kandidat për President nuk e ka fituar shumicën e nevojshme të votave, në rrethin e dytë votohet për dy kandidatët të cilët në rrethin e parë kanë fituar më së shumti vota.

Rrethi i dytë i votimit mbahet brenda afatit prej 14 ditësh nga përfundimi i rrethit të parë të votimit.

Për President është zgjedhur kandidati i cili ka fituar shumicën e votave të zgjedhësve të cilët kanë votuar, në qoftë se kanë votuar më shumë se gjysma e zgjedhësve.

Në qoftë se edhe në rrethin e dytë të votimit asnjëri nga kandidatët nuk e ka fituar shumicën e nevojshme të votave, përsëritet e tërë procedura zgjedhore.

Nëse për President të Republikës është propozuar një kandidat, ndërsa në rrethin e parë të votimit nuk e ka fituar shumicën e nevojshme të votave, përsëritet e tërë procedura zgjedhore.

Zgjedhja e Presidentit të Republikës bëhet në 60 ditët e fundit të mandatit të Presidentit të mëparshëm. Në rast të pushimit të mandatit të Presidentit të Republikës nga cilat do qoftë shkaqe, zgjedhja e Presidentit të ri bëhet brenda afatit prej 40 ditësh nga dita e pushimit të mandatit.

Para marrjes së detyrës, Presidenti i Republikës jep deklaratë solemne para Kuvendit me të cilën obligohet në respektimin e Kushtetutës dhe ligjeve.

**) Paragrafi 5 i këtij neni është zëvendësuar me Amendamentin XXXI të Kushtetutës së Republikës të Maqedonisë.*

AMENDAMENTI XXXI

1. Për President është zgjedhur kandidati që ka fituar shumicën e votave të zgjedhësve që kanë votuar, nëse kanë votuar më shumë se 40% të zgjedhësve.

2. Me këtë amendament zëvendësohet paragrafi 5 i nenit 81 të Kushtetutës së Republikës të Maqedonisë.

Neni 82

Në rast të vdekjes, dorëheqjes, pamundësisë së përhershme që ta ushtrojë funksionin ose pushimit të mandatit sipas fuqisë së Kushtetutës, deri në zgjedhjen e Presidentit të ri të Republikës, funksionin e Presidentit të Republikës e ushtron Kryetari i Kuvendit.

Ekzistimin e kushteve për pushimin e funksionit të Presidentit të Republikës e verifikon Gjykata Kushtetuese e Republikës së Maqedonisë sipas detyrës zyrtare.

Në rast të pamundësisë që ta ushtrojë funksionin, Presidentin e Republikës e zëvendëson Kryetari i Kuvendit.

Kur Kryetari i Kuvendit e ushtron funksionin e Presidentit të Republikës, ai merr pjesë në punën e Kuvendit pa të drejtë vendosjeje.

Neni 83

Detyra e Presidentit të Republikës nuk pajtohet me ushtrimin e funksionit, profesionit tjetër publik ose funksionit në parti politike.

Presidenti i Republikës gëzon imunitet.

Për heqjen e imunitetit të Presidentit të Republikës vendos Gjykata Kushtetuese e Republikës së Maqedonisë me shumicë prej dy të tretave të votave nga numri i përgjithshëm i gjyqtarëve.

Neni 84**)

Presidenti i Republikës së Maqedonisë:

- cakton mandatarin për formimin e Qeverisë së Republikës të Maqedonisë;
- emëron dhe revokon me dekret ambasadorët dhe përfaqësuesit e Republikës së Maqedonisë jashtë vendit;
- pranon letrat kredenciale dhe revokuese të përfaqësuesve të huaj diplomatikë;
- propozon dy gjyqtarë të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Maqedonisë;
- propozon dy anëtarë të Këshillit Gjyqësor Republikan;
- emëron tre anëtarë të Këshillit për Siguri të Republikës së Maqedonisë;
- i propozon anëtarët e Këshillit për Marrëdhënie Ndëretnike;
- emëron dhe shkarkon edhe bartës të tjerë të funksioneve shtetërore dhe publike të përcaktuara me Kushtetutë dhe me ligj;
- ndan dekorata dhe mirënjohje në përputhje me ligjin;
- bën faljen në përputhje me ligjin, dhe
- kryen detyra të tjera të përcaktuara me Kushtetutë.

**) Alineja 5 e këtij neni është zëvendësuar me Amendamentin XXII të Kushtetutës së Republikës të Maqedonisë, ndërsa Alineja 7 e këtij neni shlyhet me pikën 1 të Amendamentit XII të Kushtetutës së Republikës të Maqedonisë. (shih Nenin 78).*

AMENDAMENTI XXII

- 1. Propozon dy anëtarë të Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë**
- 2. Me këtë amendament zëvendësohet alineja 5 e nenit 84 të Kushtetutës së Republikës të Maqedonisë.**

Neni 85

Presidenti i Republikës i raporton Kuvendit për çështjet nga kompetenca e tij së paku një herë brenda vitit.

Kuvendi mund të kërkojë nga Presidenti i Republikës mendim për çështje nga kompetenca e tij.

Neni 86^{*)}

Presidenti i Republikës është Kryetar i Këshillit për Siguri të Republikës së Maqedonisë.

Këshillin për Siguri të Republikës e përbëjnë: Presidenti i Republikës, Kryetari i Kuvendit, Kryetari i Qeverisë, ministrat të cilët udhëheqin me organet e administratës shtetërore në fushat e sigurisë, mbrojtjes dhe të punëve të jashtme dhe tre anëtarë të cilët i emëron Presidenti i Republikës.

Këshilli shqyrton çështje lidhur me sigurinë dhe mbrojtjen e Republikës dhe i jep propozime Kuvendit dhe Qeverisë.

**) Paragrafi 2 i këtij neni është plotësuar me Amendamentin XIII të Kushtetutës së Republikës të Maqedonisë.*

AMENDAMENTI XIII

1. Gjatë emërimit të tre anëtarëve, Presidenti do të sigurojë që përbërja e Këshillit, si tërësi, në mënyrë përkatëse ta pasqyrojë përbërjen e popullatës në Republikën e Maqedonisë.

2. Me pikën 1 të këtij amendamenti plotësohet paragrafi 2 i nenit 86 të Kushtetutës së Republikës të Maqedonisë.

Neni 87

Presidenti i Republikës mban përgjegjësi për shkeljen e Kushtetutës dhe të ligjeve gjatë ushtrimit të të drejtave dhe detyrave të tij.

Procedurë për verifikimin e përgjegjësisë së Presidentit të Republikës, ngre Kuvendi me shumicën e dy të tretave të votave nga numri i përgjithshëm i deputetëve. Për përgjegjësinë e Presidentit vendos Gjykata Kushtetuese me shumicë prej dy të tretave të votave nga numri i përgjithshëm i gjyqtarëve.

Nëse Gjykata Kushtetuese e verifikon përgjegjësinë e Presidentit të Republikës, funksioni i pushon me fuqinë e Kushtetutës.

3. Qeveria e Republikës së Maqedonisë

Neni 88

Qeveria e Republikës së Maqedonisë është bartëse e pushtetit ekzekutiv.

Të drejtat dhe detyrat e veta Qeveria i ushtron në bazë dhe në kuadër të Kushtetutës dhe ligjeve.

Neni 89^{*)}

Qeverinë e përbëjnë Kryeministri dhe ministrat.

Kryeministri dhe ministrat nuk mund të jenë deputetë në Kuvend.

Kryeministri dhe ministrat gëzojnë imunitet. Për imunitetin e tyre vendos Qeveria.

Kryeministri dhe ministrat nuk i nënshtrohen detyrimit në forcat e armatosura.

Funksioni Kryetar i Qeverisë dhe ministër nuk pajtohet me ushtrimin e funksioneve ose profesioneve të tjera publike.

Organizimi dhe mënyra e punës së Qeverisë rregullohet me ligj.

**) Paragrafi 3 i këtij neni është zëvendësuar me Amendamentin XXIII të Kushtetutës së Republikës të Maqedonisë.*

AMENDAMENTI XXIII

1. Kryeministri gëzon imunitet. Për imunitetin e tij vendos Kuvendi.

2. Me këtë amendament zëvendësohet paragrafi 3 i nenit 89 të Kushtetutës së Republikës të Maqedonisë.

Neni 90

Presidenti i Republikës së Maqedonisë e ka për detyrë që në afat prej dhjetë ditëve, nga dita e konstituimit të Kuvendit, mandatin për formimin e Qeverisë t'ia besojë kandidatit të partisë, përkatësisht partive që kanë shumicë në Kuvend.

Mandatarin, në afat prej 20 ditëve, nga dita e besimit të mandatarit, Kuvendi ia paraqet programin dhe i propozon përbërjen e Qeverisë.

Qeverinë, me propozim të mandatarit dhe në bazë të programit, e zgjedh Kuvendi me shumicën e votave nga numri i përgjithshëm i deputetëve.

Neni 91^{*)}

Qeveria e Republikës së Maqedonisë:

- cakton politikën e zbatimit të ligjeve dhe rregullave të tjera të Kuvendit dhe mban përgjegjësi për zbatimin e tyre;
- propozon ligje, Buxhetin e Republikës dhe rregulla të tjera të cilat i nxjerr Kuvendi;
- propozon planin hapësinor të Republikës;
- propozon vendime për rezervat e Republikës dhe kujdeset për realizimin e tyre;
- miraton urdhëresa dhe rregulla të tjera për zbatimin e ligjeve;
- cakton parimet për organizimin e brendshëm dhe për punën e ministrive dhe organeve të tjera të administratës, orienton dhe bën mbikëqyrje mbi punën e tyre;
- jep mendime për propozim-ligjet dhe rregullat e tjera të cilat Kuvendi ia paraqesin propozuesit e tjerë të autorizuar;
- vendos për njohjen e shteteve dhe qeverive;
- vë marrëdhënie diplomatike dhe konsullore me shtetet e tjera;

- merr vendime për hapjen e përfaqësive diplomatike-konsullore jashtë vendit;
- propozon emërimin e ambasadorëve dhe përfaqësuesve të Republikës së Maqedonisë jashtë vendit dhe emëron shefat e përfaqësive konsullore;
- propozon Prokuror Publik;
- bën emërimë dhe shkarkime të bartësve të funksioneve publike dhe funksioneve të tjera të përcaktuara me Kushtetutë dhe me ligj, dhe
- kryen punë të tjera të përcaktuara me Kushtetutë dhe me ligj.

**) Alineja 12 e këtij neni është zëvendësuar me Amendamentin XXIV të Kushtetutës së Republikës të Maqedonisë.*

AMENDAMENTI XXIV

1. Propozon Prokuror Publik të Republikës së Maqedonisë me mendim paraprak të Këshillit të Prokurorëve Publikë;

2. Me këtë amendament zëvendësohet alineja 12 e nenit 91 të Kushtetutës së Republikës të Maqedonisë.

Neni 92

Qeveria dhe çdo anëtar i saj, për punën e vet përgjigjen para Kuvendit.

Kuvendi mund t'i votojë mosbesimin Qeverisë.

Mocion besimi Qeverisë mund t'i parashtrojnë së paku 20 deputetë.

Votimi për besimin e Qeverisë bëhet pas kalimit të tri ditëve nga parashtrimi i mocionit për besim.

Mocion i sërishëm për besim të Qeverisë nuk mund të parashtrohet para kalimit të 90 ditëve prej votimit të fundit të mocionit për besim, përveç nëse mocionin e besimit e parashtrojnë shumica nga numri i përgjithshëm i deputetëve.

Vendimi për votimin e mosbesimit të Qeverisë merret me shumicën e votave nga numri i përgjithshëm i deputetëve. Nëse Qeverisë i është votuar mosbesimi, Qeveria e ka për detyrë të paraqesë dorëheqje.

Neni 93

Qeveria ka të drejtë të parashtrojë mocion besimi para Kuvendit.

Qeveria ka të drejtë të paraqesë dorëheqje.

Dorëheqja e Kryetarit të Qeverisë, vdekja ose pamundësia e përhershme e tij që ta ushtrojë funksionin, rezulton me dorëheqjen e Qeverisë.

Qeverisë i pushon mandati kur shpërndahet Kuvendi.

Qeveria, së cilës i është votuar mosbesimi, e cila ka dhënë dorëheqje ose së cilës i pushon mandati për shkak të shpërndarjes së Kuvendit, mbetet në detyrë deri në zgjedhjen e Qeverisë së re.

Neni 94

Anëtari i Qeverisë ka të drejtë të paraqesë dorëheqje.

Kryetari i Qeverisë mund të propozojë shkarkimin e anëtarit të Qeverisë.

Për propozimin për shkarkimin e anëtarit të Qeverisë vendos Kuvendi në seancën e parë të ardhshme.

Në qoftë se Kryetari i Qeverisë propozon shkarkimin e më shumë se një të tretës së anëtarëve të Qeverisë të përbërjes fillestare, Kuvendi vendos sikur për zgjedhjen e Qeverisë së re.

Neni 95

Administratën shtetërore e përbëjnë ministrinë dhe organet e tjera të administratës dhe organizatat e përcaktuara me ligj.

Ndalohet organizimi dhe veprimi politik në organet e administratës shtetërore.

Organizimi dhe puna e organeve të administratës shtetërore rregullohet me ligj i cili nxirret me shumicë prej dy të tretave të votave nga numri i përgjithshëm i deputetëve.

Neni 96

Organet e administratës shtetërore punët nga kompetenca e tyre i ushtrojnë në mënyrë të pavarur në bazë dhe në kuadër të Kushtetutës dhe ligjeve dhe për punën e tyre i përgjigjen Qeverisë.

Neni 97

Organet e administratës shtetërore në fushën e mbrojtjes dhe policisë i udhëheqin persona civilë, të cilët drejtpërsëdrejti para zgjedhjes në ato funksione kanë qenë civilë së paku tre vjet.

4. Gjyqësori

Neni 98^{*)}

Pushtetin gjyqësor e ushtrojnë gjykatat.

Gjykatat janë të mëvetësishme dhe të pavarura. Gjykatat gjykojnë në bazë të Kushtetutës e të ligjeve dhe të marrëveshjeve ndërkombëtare të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.

Organizimi i gjyqësisë është unik.

Ndalohen gjykatat e jashtëzakonshme.

Llojet, kompetencat, themelimi, suprimimi, organizimi dhe përbërja e gjykatave, si dhe procedura para tyre, rregullohen me ligj, i cili nxirret me shumicë prej dy të tretave të votave nga numri i përgjithshëm i deputetëve.

**) Ky nen është zëvendësuar me Amendamentin XXV të Kushtetutës së Republikës të Maqedonisë.*

AMENDAMENTI XXV

1. Pushtetin gjyqësor e ushtrojnë gjykatat.

Gjykatat janë të mëvetësishme dhe të pavarura. Gjykatat gjykojnë në bazë të Kushtetutës e të ligjeve dhe të marrëveshjeve ndërkombëtare të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.

Ndalohen gjykatat e jashtëzakonshme.

Llojet, kompetencat, themelimi, suprimimi, organizimi dhe përbërja e gjykatave, si dhe procedura para tyre, rregullohen me ligj, i cili nxirret me shumicën e dy të tretave të votave nga numri i përgjithshëm i deputetëve.

2. Me pikën 1 të këtij amendamenti zëvendësohet neni 98 i Kushtetutës së Republikës të Maqedonisë.

Neni 99^{*)}

Gjyqtari zgjidhet për një mandat të pakufizuar kohor.

Gjyqtari nuk mund të transferohet kundër vullnetit të tij.

Gjyqtari shkarkohet:

- nëse atë e kërkon vetë;
- nëse e humb përgjithmonë aftësinë e ushtrimit të funksionit të gjyqtarit, të cilën e verifikon Këshilli Gjyqësor Republikan;
- nëse i plotëson kushtet për pension pleqërie;
- nëse është dënuar për vepër penale me dënim të pakusht me burg me më së paku gjashtë muaj;
- për shkak të shkeljes së rëndë disiplinore të përcaktuar me ligj, që e bën të padenjë për ushtrimin e funksionit të gjyqtarit, që e verifikon Këshilli Gjyqësor Republikan, dhe
- për shkak të ushtrimit joprofesional dhe të pandërgjegjshëm të funksionit të gjyqtarit, të cilin në procedurë të përcaktuar me ligj e verifikon Këshilli Gjyqësor Republikan.

**) Paragrafi 3 i këtij neni është zëvendësuar me Amendamentin XXVI të Kushtetutës së Republikës të Maqedonisë.*

AMENDAMENTI XXVI

1. Gjyqtarit i pushon funksioni i gjyqtarit:

- nëse atë e kërkon vetë;
- nëse e humb përgjithmonë aftësinë për ushtrimin e funksionit të gjyqtarit, të cilën e verifikon Këshilli Gjyqësor i Republikës së Maqedonisë;
- nëse i plotëson kushtet për pension pleqërie;

- nëse është dënuar me aktgjykim të plotfuqishëm gjyqësor për vepër penale me dënim të pakusht me burg me më së paku gjashtë muaj, dhe
- nëse është zgjedhur ose emëruar në funksion tjetër publik, përveçse kur funksioni i gjyqtarit pezullohet në kushte të përcaktuara me ligj.

Gjyqtari shkarkohet:

- për shkak të shkeljes së rëndë disiplinore që e bën të padenjë për ushtrimin e funksionit të gjyqtarit të përcaktuar me ligj, dhe
- për shkak të ushtrimit joprofesional dhe të pandërgjegjshëm të funksionit të gjyqtarit në kushte të përcaktuara me ligj.

2. Me pikën 1 të këtij amendamenti zëvendësohet paragrafi 3 i nenit 99 të Kushtetutës së Republikës të Maqedonisë.

Neni 100^{*)}

Gjyqtarët gëzojnë imunitet.

Për imunitetin e gjyqtarëve vendos Kuvendi.

Funksioni i gjyqtarit nuk është në pajtim me ushtrimin e funksionit dhe profesionit tjetër publik ose me anëtarësimin në parti politike.

Ndalohet organizimi dhe veprimi politik në gjyqësi.

**) Paragrafi 2 i këtij neni është zëvendësuar me pikën 1 të Amendamentit XXVII të Kushtetutës së Republikës të Maqedonisë, ndërsa paragrafi 3 është zëvendësuar me pikën 2 të Amendamentit të njëjtë.*

AMENDAMENTI XXVII

1. Gjyqtari nuk mund të merret në përgjegjësi penale për mendimin e shprehur dhe për votën e dhënë me rastin e marrjes së vendimeve gjyqësore.

Gjyqtari nuk mund të arrestohet pa pëlqimin e Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë, përveç nëse është kapur

në kryerje e sipër të veprës penale për të cilën është përcaktuar dënim me burg në kohëzgjatje prej së paku pesë vjet.

2. Funkcioni i gjyqtarit nuk pajtohet me anëtarësimin në parti politike ose me ushtrimin e funksionit ose profesionit tjetër publik të përcaktuar me ligj.

3. Me pikën 1 të këtij amendamenti zëvendësohet paragrafi 2 i nenit 100 të Kushtetutës së Republikës të Maqedonisë, ndërsa me pikën 2 të këtij amendamenti zëvendësohet paragrafi 3 i nenit 100 të Kushtetutës së Republikës të Maqedonisë.

Neni 101

Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë është gjykata më e lartë në Republikë dhe e siguron unitetin në zbatimin e ligjeve nga ana e gjykatave.

Neni 102

Shqyrtimi para gjykatave dhe shqiptimi i aktgjykimit janë publikë.

Publiku mund të përjashtohet në raste të përcaktuara me ligj.

Neni 103

Gjykata gjykon në kolegji.

Me ligj përcaktohet kur gjyqtari gjykon si gjyqtar i vetëm.

Në gjykim marrin pjesë edhe gjyqtarë porotë kur kjo është përcaktuar me ligj.

Gjyqtarët porotë nuk mund të merren në përgjegjësi për mendimin e shprehur dhe për votën e dhënë me rastin e marrjes së vendimeve gjyqësore.

Këshillin Gjyqësor Republikan e përbëjnë shtatë anëtarë.

Kuvendi i zgjedh anëtarët e Këshillit.

Anëtarët e Këshillit zgjidhen nga radhët e juristëve të shquar me mandat gjashtëvjeçar, me të drejtë edhe për një zgjedhje.

Anëtarët e Këshillit Gjyqësor Republikan gëzojnë imunitet.

Për imunitetin e tyre vendos Kuvendi.

Funksioni anëtar i Këshillit Gjyqësor Republikan nuk pajtohet me ushtrimin e funksioneve dhe profesioneve të tjera publike ose me anëtarësimin në parti politike.

**) Ky nen i cili ishte plotësuar me Amendamentin XIV të Kushtetutës së Republikës të Maqedonisë, është zëvendësuar me Amendamentin XXVIII të Kushtetutës së Republikës të Maqedonisë.*

AMENDAMENTI XXVIII

1. Këshilli Gjyqësor i Republikës së Maqedonisë është organ i mëvetësishëm dhe i pavarur i gjyqësisë. Këshilli e siguron dhe e garanton mëvetësinë dhe pavarësinë e pushtetit gjyqësor.

Këshillin e përbëjnë pesëmbëdhjetë anëtarë.

Sipas funksionit anëtarë të Këshillit janë: Kryetari i Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë dhe Ministri i Drejtësisë.

Tetë anëtarë të Këshillit i zgjedhin gjyqtarët nga radhët e tyre.

Tre nga anëtarët e zgjedhur janë pjesëtarë të bashkësive të cilët nuk janë shumicë në Republikën e Maqedonisë, me ç'rast do të respektohet përfaqësimi adekuat dhe i drejtë i qytetarëve të cilët u takojnë të gjitha bashkësive.

Tre anëtarë të Këshillit i zgjedh Kuvendi i Republikës së Maqedonisë me shumicën e votave nga numri i përgjithshëm i deputetëve, me ç'rast medoemos duhet të ketë shumicë të votave nga numri i përgjithshëm i deputetëve të cilët u takojnë

bashkësive të cilat nuk janë shumicë në Republikën e Maqedonisë.

Dy anëtarë të Këshillit i propozon Presidenti i Republikës së Maqedonisë, ndërsa zgjedhjen e bën Kuvendi i Republikës së Maqedonisë, prej të cilëve njëri është pjesëtar i bashkësive të cilat nuk janë shumicë në Republikën e Maqedonisë.

Anëtarët e Këshillit që i zgjedh Kuvendi i Republikës së Maqedonisë, përkatësisht që i propozon Presidenti i Republikës së Maqedonisë janë nga radhët e profesorëve universitarë të drejtësisë, avokatëve dhe juristëve të tjerë të shquar.

Mandati i anëtarëve të zgjedhur të Këshillit zgjatë gjashtë vjet, me të drejtë edhe për një zgjedhje.

Kushtet dhe procedura për zgjedhjen, si dhe bazat dhe procedura për pushimin e funksionit dhe shkarkimin e anëtarit të Këshillit rregullohen me ligj.

Funksioni anëtar i zgjedhur i Këshillit nuk pajtohet me anëtarësimin në parti politike ose me ushtrimin e funksioneve dhe profesioneve të tjera publike të përcaktuara me ligj.

2. Me këtë amendament zëvendësohet neni 104 i Kushtetutës së Republikës të Maqedonisë.

Neni 105*)

Këshilli Gjyqësor Republikan:

- Kuvendit i propozon zgjedhjen dhe shkarkimin e gjyqtarëve dhe e përcakton propozimin për shkarkimin nga funksioni i gjyqtarit në rastet e përcaktuara me Kushtetutë;
- vendos për përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve;
- e vlerëson profesionalizmin dhe ndërgjegjen e gjyqtarëve gjatë ushtrimit të funksionit të tyre; dhe
- propozon dy gjyqtarë të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Maqedonisë.

**) Ky nen është zëvendësuar me Amendamentin XXIX të Kushtetutës së Republikës të Maqedonisë.*

AMENDAMENTI XXIX

1. Këshilli Gjyqësor i Republikës së Maqedonisë:

- zgjedh dhe shkarkon gjyqtarë dhe gjyqtarë porotë;
- verifikon pushimin e funksionit të gjyqtarit;
- zgjedh dhe shkarkon kryetarët e gjykatave;
- ndjek dhe vlerëson punën e gjyqtarëve;
- vendos për përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve;
- vendos për heqjen e imunitetit të gjyqtarëve;
- propozon dy gjyqtarë të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Maqedonisë nga radhët e gjyqtarëve, dhe
- kryen punë të tjera të përcaktuara me ligj.

Gjatë zgjedhjes së gjyqtarëve, gjyqtarëve porotë dhe kryetarëve të gjykatave do të respektohet përfaqësimi adekuat dhe i drejtë i qytetarëve të cilët u takojnë të gjitha bashkësive.

Këshilli për punën e tij i paraqet raport vjetor Kuvendit të Republikës së Maqedonisë, forma, përmbajtja dhe mënyra e miratimit të të cilit rregullohen me ligj.

2. Me këtë amendament zëvendësohet neni 105 i Kushtetutës së Republikës të Maqedonisë dhe shlyhet alineja 15 e paragrafit 1 të nenit 68 të Kushtetutës së Republikës të Maqedonisë.

5. Prokuroria Publike

Neni 106^{*)}

Prokuroria Publike është organ unik dhe i mëvetësishëm shtetëror i cili i ndjek kryerësit e veprave penale dhe të veprave të tjera të ndëshkueshme të përcaktuara me ligj dhe kryen edhe punë të tjera të përcaktuara me ligj.

Prokuroria Publike funksionet e veta i ushtron në bazë dhe në kuadër të Kushtetutës dhe ligjit.

Prokurorin Publik e emëron dhe shkarkon Kuvendi në kohëzgjatje prej gjashtë vitesh.

**) Paragrafët 2 dhe 3 të këtij neni janë zëvendësuar me Amendamentin XXX të Kushtetutës së Republikës të Maqedonisë.*

AMENDAMENTI XXX

1. Prokuroria Publike, funksionet e veta i ushtron në bazë të Kushtetutës e të ligjeve dhe të marrëveshjeve ndërkombëtare të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.

Funksionin e Prokurorisë Publike e ushtrojnë Prokurori Publik i Republikës së Maqedonisë dhe prokurorët publikë.

Kompetencat, themelimi, suprimimi, organizimi dhe funksionimi i Prokurorisë Publike rregullohet me ligj, i cili nxirret me shumicë prej dy të tretave të votave nga numri i përgjithshëm i deputetëve.

Prokurorin Publik të Republikës së Maqedonisë e emëron dhe e shkarkon Kuvendi i Republikës së Maqedonisë me kohëzgjatje prej gjashtë vitesh me të drejtë rizgjedhjeje.

Prokurorët publikë i zgjedh Këshilli i Prokurorëve Publikë pa kufizim të kohëzgjatjes së mandatit.

Gjatë zgjedhjes të prokurorëve publikë do të respektohet përfaqësimi adekuat dhe i drejtë i qytetarëve të cilët u takojnë të gjitha bashkësive.

Për shkarkimin e prokurorëve publikë vendos Këshilli.

Kompetencat, përbërja dhe struktura e Këshillit, mandati i anëtarëve të tij, si dhe bazat dhe procedura për pushimin dhe shkarkimin e anëtarit të Këshillit rregullohen me ligj.

Bazat dhe procedura për pushimin dhe shkarkimin e Prokurorit Publik të Republikës së Maqedonisë dhe të prokurorëve publikë rregullohet me ligj.

Funksioni Prokuror Publik i Republikës së Maqedonisë dhe Prokuror Publik nuk është në pajtim me anëtarësimin në parti politike ose me ushtrimin e funksioneve dhe profesioneve të tjera publike të përcaktuara me ligj.

Ndalohet organizimi dhe veprimi politik në Prokurorinë Publike.

2. Me këtë amendament zëvendësohen paragrafët 2 dhe 3 të nenit 106 të Kushtetutës së Republikës të Maqedonisë dhe shlyhet neni 107 i Kushtetutës së Republikës të Maqedonisë.

Neni 107*)

Prokurori Publik gëzon imunitet.

Për imunitetin e tij vendos Kuvendi.

Funksioni Prokuror Publik nuk është në pajtim me ushtrimin e funksionit dhe profesionit tjetër publik ose me anëtarësimin në parti politike.

**) Ky nen shlyhet me Amendamentin XXX të Kushtetutës së Republikës të Maqedonisë (shih Nenin 106).*

IV. GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË

Neni 108

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Maqedonisë është organ i Republikës i cili mbron kushtetutshmërinë dhe ligjshmërinë.

Neni 109*)

Gjykatën Kushtetuese e përbëjnë nëntë gjyqtarë.

Kuvendi i zgjedh gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese me shumicën e votave nga numri i përgjithshëm i deputetëve. Mandati i gjyqtarëve zgjat nëntë vjet, pa të drejtë rizgjedhjeje.

Gjykata Kushtetuese nga radhët e veta zgjedh kryetarin me kohëzgjatje prej tre vjetësh dhe pa të drejtë rizgjedhjeje.

Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese zgjidhen nga radhët e juristëve të shquar.

**) Paragrafi 2 i këtij neni është zëvendësuar me Amendamentin XV të Kushtetutës së Republikës të Maqedonisë.*

AMENDAMENTI XV

1. Kuvendi i zgjedh gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese. Kuvendi zgjedh gjashtë gjyqtarë të Gjykatës Kushtetuese me shumicën e votave nga numri i përgjithshëm i deputetëve. Kuvendi zgjedh tre gjyqtarë me shumicën e votave nga numri i përgjithshëm i deputetëve, me ç'rast medoemos duhet të ketë shumicë të votave nga numri i përgjithshëm i deputetëve të cilët u takojnë bashkësive të cilat nuk janë shumicë në Republikën e Maqedonisë. Mandati i gjyqtarëve zgjat nëntë vjet, pa të drejtë rizgjedhjeje.

2. Me këtë amendament zëvendësohet paragrafi 2 i nenit 109 të Kushtetutës së Republikës të Maqedonisë.

Neni 110

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Maqedonisë:

- vendos për përputhshmërinë e ligjeve me Kushtetutën;
- vendos për përputhshmërinë e rregullave të tjera dhe të marrëveshjeve kolektive me Kushtetutën dhe me ligjet;
- i mbron liritë dhe të drejtat e njeriut e të qytetarit, që kanë të bëjnë me lirinë e bindjes, ndërgjegjes, mendimit dhe shprehjes publike të mendimeve, bashkimin dhe veprimin politik dhe ndalimin e diskriminimit të qytetarëve mbi bazë të gjinisë, racës, fesë, përkatësisë kombëtare, sociale dhe politike;
- vendos për konfliktin e kompetencave midis bartësve të pushtetit ligjvënës, ekzekutiv dhe gjyqësor;
- vendos për konfliktin e kompetencave midis organeve të Republikës dhe njësisë të vetadministrimit lokal;
- vendos për përgjegjësinë e Presidentit të Republikës;
- vendos për kushtetutshmërinë e programeve dhe statuteve të partive politike dhe të shoqatave civile, dhe
- vendos edhe për çështje të tjera të përcaktuara me Kushtetutë.

Neni 111

Funksioni gjyqtar i Gjykatës Kushtetuese nuk pajtohet me ushtrimin e funksionit dhe profesionit tjetër publik ose me anëtarësimin në parti politike.

Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese gëzojnë imunitet. Për imunitetin e tyre vendos Gjykata Kushtetuese.

Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese nuk i nënshtrohen detyrimit në forcat e armatosura.

Gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese i pushon funksioni nëse paraqet dorëheqje. Gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese do të shkarkohet nga detyra nëse dënohet për vepër penale me dënim të pakusht me burg me më së paku gjashtë muaj ose kur përgjithmonë do ta humb aftësinë për ushtrimin e funksionit të tij, të cilën e verifikon Gjykata Kushtetuese.

Neni 112

Gjykata Kushtetuese do të abrogojë ose shfuqizojë ligjin nëse konstaton se nuk është në përputhje me Kushtetutën.

Gjykata Kushtetuese do të abrogojë ose shfuqizojë rregull tjetër ose akt të përgjithshëm, marrëveshje kolektive, statut apo program të partisë politike ose të shoqatës, nëse konstaton se të njëjtat nuk janë në përputhje me Kushtetutën ose me ligjin.

Vendimet e Gjykatës Kushtetuese janë të formës së prerë dhe të ekzekutueshme.

Neni 113

Mënyra e punës dhe procedura para Gjykatës Kushtetuese rregullohen me akt të Gjykatës.

V. VETADMINISTRIMI LOKAL

Neni 114^{*)}

Qytetarëve u garantohet e drejta e vetadministrimit lokal.

Njësitë e vetadministrimit lokal janë komunat.

Në komuna mund të themelohen forma të vetadministrimit vendor.

Komunat financohen nga burime vetjake të të hyrave të përcaktuara me ligj dhe me mjete nga Republika.

Vetadministrimi lokal rregullohet me ligj i cili nxirret me shumicë prej dy të tretave të votave nga numri i përgjithshëm i deputetëve.

**) Paragrafi 5 i këtij neni është zëvendësuar me Amendamentin XVI të Kushtetutës së Republikës të Maqedonisë.*

AMENDAMENTI XVI

1. Vetadministrimi lokal rregullohet me ligj i cili nxirret me shumicë prej dy të tretave të votave nga numri i përgjithshëm i deputetëve, me ç'rast medoemos duhet të ketë shumicë të votave nga numri i përgjithshëm i deputetëve të cilët u takojnë bashkësive të cilat nuk janë shumicë në Republikën e Maqedonisë. Ligjet për financimin lokal, zgjedhjet lokale, kufijtë komunalë dhe për Qytetin e Shkupit, nxirren me shumicën e votave nga deputetët e pranishëm, me ç'rast medoemos duhet të ketë shumicë të votave nga deputetët e pranishëm të cilët u takojnë bashkësive që nuk janë shumicë në Republikën e Maqedonisë.

2. Me këtë amendament zëvendësohet paragrafi 5 i nenit 114 të Kushtetutës së Republikës të Maqedonisë.

Neni 115^{*)}

Në njësitë e vetadministrimit lokal qytetarët në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe nëpërmjet përfaqësuesve marrin pjesë në vendimmarrje për çështjet me rëndësi lokale, e veçanërisht në fushat e urbanizmit, veprimtarive komunale, kulturës, sportit, mbrojtjes sociale dhe të fëmijëve, edukimit parashkollor, arsimit fillor, mbrojtjes themelore shëndetësore dhe në fusha të tjerë të përcaktuara me ligj.

Komuna është e pavarur në ushtrimin e kompetencave të përcaktuara me Kushtetutë dhe me ligj, ndërsa mbikëqyrjen mbi ligjshmërinë e punës së saj e bën Republika.

Republika me ligj mund t'ia besojë komunës kryerjen e punëve të caktuara.

**) Paragrafi 1 i këtij neni është zëvendësuar me pikën 1 të Amendamentit XVII të Kushtetutës së Republikës të Maqedonisë.*

AMENDAMENTI XVII

1. Në njësitë e vetadministrimit lokal qytetarët në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe nëpërmjet përfaqësuesve marrin pjesë në vendimmarrje për çështje me rëndësi lokale, e veçanërisht në fushat e shërbimeve publike, urbanizmit dhe planifikimit rural, mbrojtjes së mjedisit jetësor, zhvillimit ekonomik lokal, financimit lokal, veprimtarive komunale, kulturës, sportit, mbrojtjes sociale dhe të fëmijëve, arsimit, mbrojtjes shëndetësore dhe në fusha të tjera të përcaktuara me ligj.

2. Në Qytetin e Shkupit qytetarët në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe nëpërmjet përfaqësuesve marrin pjesë në vendimmarrje për çështje me rëndësi për Qytetin e Shkupit, e veçanërisht në fushat e shërbimeve publike, urbanizmit dhe planifikimit rural, mbrojtjes së mjedisit jetësor, zhvillimit ekonomik lokal, financimit lokal, veprimtarive komunale, kulturës, sportit, mbrojtjes sociale dhe të fëmijëve, arsimit, mbrojtjes shëndetësore dhe në fusha të tjera të përcaktuara me ligj.

3. Me pikën 1 të këtij amendamenti zëvendësohet paragrafi 1 i nenit 115 të Kushtetutës së Republikës të Maqedonisë, ndërsa me pikën 2 zëvendësohet paragrafi 2 i nenit 117 të Kushtetutës së Republikës të Maqedonisë.

Neni 116

Ndarja territoriale e Republikës dhe rajonet e komunave përcaktohen me ligj.

Neni 117*)

Qyteti i Shkupit është njësi e veçantë e vetadministrimit lokal, organizimi i të cilit rregullohet me ligj.

Në Qytetin e Shkupit qytetarët në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe nëpërmjet përfaqësuesve marrin pjesë në vendimmarrje për çështje të rëndësishme për Qytetin e Shkupit, e veçanërisht në fushat e urbanizmit, veprimtarive komunale, kulturës, sportit, mbrojtjes sociale dhe të fëmijëve, edukimit parashkollor, arsimit fillor, mbrojtjes themelore shëndetësore dhe në fusha të tjera të përcaktuara me ligj.

Qyteti i Shkupit financohet nga burimet vetjake të të hyrave të përcaktuara me ligj dhe me mjete nga Republika.

Qyteti i Shkupit është i pavarur në ushtrimin e kompetencave të përcaktuara me Kushtetutë dhe me ligj, ndërsa mbikëqyrjen mbi ligjshmërinë e punës së tij e bën Republika.

Republika me ligj mund t'ia besojë Qytetit të Shkupit kryerjen e punëve të caktuara.

**) Paragrafi 2 i këtij neni është zëvendësuar me pikën 2 të Amendamentit XVII të Kushtetutës së Republikës të Maqedonisë (shih Nenin 115).*

VI. MARRËDHËNIET NDËRKOMBËTARE

Neni 118

Marrëveshjet ndërkombëtare të cilat janë ratifikuar në përputhje me Kushtetutën janë pjesë e rendit juridik të brendshëm dhe nuk mund të ndryshohen me ligj.

Neni 119

Marrëveshjet ndërkombëtare në emër të Republikës së Maqedonisë i lidh Presidenti i Republikës së Maqedonisë.

Marrëveshje ndërkombëtare mund të lidh edhe Qeveria e Republikës së Maqedonisë kur kjo përcaktohet me ligj.

Neni 120

Propozim për aderim në aleancë ose në bashkësi me shtete të tjera ose për dalje nga aleanca ose nga bashkësia me shtete të tjera mund të paraqesin Presidenti i Republikës, Qeveria ose së paku 40 deputetë.

Vendimin për aderim ose për dalje nga aleanca ose nga bashkësia me shtetet tjera e merr Kuvendi me shumicë prej dy të tretave të votave nga numri i përgjithshëm i deputetëve.

Vendimi për aderim ose për dalje nga aleanca ose nga bashkësia me shtetet tjera është miratuar, nëse në referendum për të ka votuar shumica nga numri i përgjithshëm i zgjedhësve.

Neni 121

Vendim për aderim ose për dalje nga aderimi nga organizatat ndërkombëtare merr Kuvendi me shumicën e votave nga numri i përgjithshëm i deputetëve me propozim të Presidentit të Republikës, Qeverisë ose së paku të 40 deputetëve.

VII. MBROJTJA E REPUBLIKËS, GJENDJA E LUFTËS DHE GJENDJA E JASHTËZAKONSHME

Neni 122

Forcat e Armatosura të Republikës së Maqedonisë e mbrojnë integritetin territorial dhe pavarësinë e Republikës.

Mbrojtja e Republikës rregullohet me ligj, i cili nxirret me shumicë prej dy të tretave të votave nga numri i përgjithshëm i deputetëve.

Neni 123

Askush nuk ka të drejtë të pranojë okupimin e Republikës së Maqedonisë ose të ndonjë pjese të saj.

Neni 124

Gjendja e luftës fillon kur paraqitet rreziku i drejtpërdrejtë i luftës nga sulmi ndaj Republikës ose kur Republika është sulmuar ose i është shpallur luftë.

Gjendje lufte shpall Kuvendi me shumicë prej dy të tretave të votave nga numri i përgjithshëm i deputetëve, me propozim të Presidentit të Republikës, Qeverisë ose së paku të 30 deputetëve.

Nëse Kuvendi nuk mund të mblidhet, vendimin për shpalljen e gjendjes së luftës e merr Presidenti i Republikës dhe ia paraqet Kuvendit për konfirmim sapo ai të ketë mundësi të mblidhet.

Neni 125

Gjendja e jashtëzakonshme paraqitet kur ndodhin fatkeqësi të mëdha natyrore ose epidemi.

Ekzistimin e gjendjes së jashtëzakonshme në territorin e Republikës së Maqedonisë ose të një pjese të saj e cakton Kuvendi me propozim të Presidentit të Republikës, Qeverisë ose së paku të 30 deputetëve.

Vendimi me të cilin caktohet ekzistimi i gjendjes së jashtëzakonshme merret me shumicë prej dy të tretave të votave nga numri i përgjithshëm i deputetëve dhe vlen më së shumti 30 ditë.

Nëse Kuvendi nuk mund të mblidhet, vendimin për ekzistimin e gjendjes së jashtëzakonshme e merr Presidenti i Republikës dhe ia paraqet Kuvendit për konfirmim sapo ai të ketë mundësi të mblidhet.

Neni 126

Në rast të ekzistimit të gjendjes së luftës ose gjendjes së jashtëzakonshme Qeveria në përputhje me Kushtetutën dhe me ligjin miraton urdhëresa me fuqi ligjore.

Autorizimi i Qeverisë që të miratojë urdhëresa me fuqi ligjore zgjat deri në përfundimin e gjendjes së luftës ose gjendjes së jashtëzakonshme, për të cilën vendos Kuvendi.

Neni 127

Gjatë kohës së gjendjes së luftës, nëse Kuvendi nuk mund të mblidhet, Presidenti i Republikës mund ta emërojë dhe shkarkojë Qeverinë dhe të emërojë dhe shkarkojë funksionarë, zgjedhja e të cilëve është në kompetencë të Kuvendit.

Neni 128

Mandati i Presidentit të Republikës, Qeverisë, gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese dhe të anëtarëve të Këshillit Gjyqësor Republikan vazhdohet për atë kohë sa zgjat gjendja e luftës ose gjendja e jashtëzakonshme.

VIII. NDRYSHIMI I KUSHTETUTËS

Neni 129

Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë ndryshohet dhe plotësohet me amendamente kushtetuese.

Neni 130

Propozim për iniciimin e ndryshimit të Kushtetutës së Republikës të Maqedonisë mund të paraqesin Presidenti i Republikës, Qeveria, së paku 30 deputetë ose 150.000 qytetarë.

Neni 131^{*)}

Vendim për iniciimin e ndryshimit të Kushtetutës merr Kuvendi me shumicë prej dy të tretave të votave nga numri i përgjithshëm i deputetëve.

Skicën për ndryshimin e Kushtetutës e përcakton Kuvendi me shumicën e votave nga numri i përgjithshëm i deputetëve dhe e vë në diskutim publik.

Vendim për ndryshimin e Kushtetutës merr Kuvendi me shumicë prej dy të tretave të votave nga numri i përgjithshëm i deputetëve.

Ndryshimin e Kushtetutës e shpall Kuvendi.

**) Me Amendamentin XVIII të Kushtetutës së Republikës të Maqedonisë këtij neni i shtohet paragrafi ri 4.*

AMENDAMENTI XVIII

1. Për vendimin mbi ndryshimin e Preambulës, neneve të vetadministrimit lokal, nenit 131, cilëndo dispozitë që ka të bëjë me të drejtat e pjesëtarëve të bashkësive, përfshirë veçanërisht nenet 7, 8, 9, 19, 48, 56, 69, 77, 78, 86, 104 dhe 109, si dhe për vendimin për shtimin e çfarëdo dispozite të re, që ka të bëjë me përmbajtjen e atyre dispozitave dhe neneve, do të jetë e nevojshme shumicë prej dy të tretave të votave nga numri i

përgjithshëm i deputetëve, me ç'rast medoemos duhet të ketë shumicë të votave nga numri i përgjithshëm i deputetëve të cilët u takojnë bashkësive të cilat nuk janë shumicë në Republikën e Maqedonisë.

2. Me këtë Amendament shtohet paragrafi i ri 4 të nenit 131 të Kushtetutës së Republikës të Maqedonisë.

IX. DISPOZITA KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 132

Në kohën e parashikuar në paragrafin 5 të nenit 80 të kësaj Kushtetute llogaritet edhe koha e banimit në republikat e tjera të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë.

Neni 133

Për zbatimin e Kushtetutës do të nxirret ligji kushtetues.

Ligji kushtetues nxirret me shumicë prej dy të tretave të votave nga numri përgjithshëm i deputetëve.

Ligjin kushtetues e shpall Kuvendi dhe hyn në fuqi njëkohësisht me shpalljen e Kushtetutës.

Neni 134

Kjo Kushtetutë hyn në fuqi ditën e shpalljes nga Kuvendi i Republikës së Maqedonisë.

**AMENDAMENTE
I-XXXVI**

AMENDAMENTET^{*)}
I dhe II
të Kushtetutës së Republikës të Maqedonisë

Këto amendamente janë pjesë përbërëse të Kushtetutës së Republikës të Maqedonisë dhe hyjnë në fuqi në ditën e shpalljes së tyre.

AMENDAMENTI I

1. Republika e Maqedonisë nuk ka pretendime territoriale ndaj shteteve fqinje.

2. Kufiri i Republikës së Maqedonisë mund të ndryshohet vetëm në përputhje me Kushtetutën, mbi parimin e vullnetit të lirë dhe në përputhje me normat e përgjithshme të pranueshme ndërkombëtare.

3. Me pikën 1 të këtij amendamenti plotësohet neni 3, ndërsa me pikën 2 ndryshohet paragrafi 3 i nenit 3 të Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë.

AMENDAMENTI II

1. Republika, nuk do të përzihet në të drejtat sovrane të shteteve të tjera dhe në punët e tyre të brendshme.

2. Me këtë amendament plotësohet paragrafi 1 i nenit 49 të Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë.

^{*)} Amendamentet janë shpallur në "Gazetën zyrtare të Republikës së Maqedonisë", numër 1/92.

AMENDAMENTI III^{*)}
i Kushtetutës së Republikës të Maqedonisë

Ky amendament është pjesë përbërëse e Kushtetutës së Republikës të Maqedonisë dhe hyn në fuqi me ditën e shpalljes së tij.

AMENDAMENTI III

1. Paraburgimi deri në ngritjen e akuzës, me vendim të gjykatës, mund të zgjasë më së shumti 180 ditë nga dita e arrestimit.

Pas ngritjes së akuzës, paraburgimin e vazhdon ose e përcakton gjykata kompetente në rast dhe procedurë të përcaktuar me ligj.

2. Me këtë amendament zëvendësohet paragrafi 5 i nenit 12 të Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë.

*) Ky amendament është shpallur në "Gazetën zyrtare të Republikës së Maqedonisë", numër 31/98.

AMENDAMENTET*)

IV, V, VI, VII, VIII, IX, X, XI, XII, XIII, XIV, XV, XVI, XVII dhe XVIII

të Kushtetutës së Republikës të Maqedonisë

Këto amendamente janë pjesë përbërëse të Kushtetutës së Republikës të Maqedonisë dhe hyjnë në fuqi në ditën e shpalljes së tyre.

AMENDAMENTI IV

1. Qytetarët e Republikës së Maqedonisë, populli maqedonas, si dhe qytetarët të cilët jetojnë brenda kufijve të saj të cilët janë pjesë e popullit shqiptar, popullit turk, popullit vllleh, popullit serb, popullit rom, popullit boshnjak e të tjerë, duke e marrë përsipër përgjegjësinë për të tashmen dhe të ardhmen e atdheut të tyre, të vetëdijshëm dhe mirënjohës ndaj paraardhësve të tyre për viktimat dhe përkushtimin e përpjekjeve të tyre dhe luftës për krijimin e shtetit të pavarur dhe sovran të Maqedonisë, dhe përgjegjës para gjeneratave të ardhshme për ruajtjen dhe zhvillimin e të gjithë asaj që është e vlefshme nga trashëgimia e pasur kulturore dhe bashkëjetesa në Maqedoni, të barabartë në të drejtat dhe obligimet e tyre për të mirën e përbashkët – Republikës së Maqedonisë - në përputhje me traditën e Republikës së Krushevës dhe vendimet e KAÇKM-së dhe të Referendumit të 8 shtatorit të vitit 1991, vendosën ta konstituojnë Republikën e Maqedonisë si shtet të pavarur, sovran, me qëllim që të vendoset dhe forcohet sundimi i së drejtës, që të garantohen të drejtat e njeriut dhe liritë qytetare, të sigurohet paqja dhe bashkëjetesa, drejtësia sociale, mirëqenia ekonomike dhe përparimi i jetës individuale dhe të përbashkët, nëpërmjet përfaqësuesve të tyre në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë, të zgjedhur në zgjedhjet e lira dhe demokratike, e nxjerrin këtë

2. Me pikën 1 të këtij Amendamenti, zëvendësohet Preambula e Kushtetutës së Republikës të Maqedonisë.

*) Amendamentet janë shpallur në "Gazetën zyrtare të Republikës së Maqedonisë", numër 91/2001.

AMENDAMENTI V

1. Në tërë territorin e Republikës së Maqedonisë dhe në marrëdhëniet e saj ndërkombëtare, gjuhë zyrtare është gjuha maqedonase dhe alfabeti i saj cirilik.

Gjuhë tjetër që e flasin së paku 20% e qytetarëve, gjithashtu, është gjuhë zyrtare dhe alfabeti i saj, siç është përcaktuar me këtë nen.

Dokumentet personale të qytetarëve, të cilët flasin gjuhë zyrtare të ndryshme nga gjuha maqedonase, lëshohen në gjuhën maqedonase dhe alfabetin e saj, si dhe në atë gjuhë dhe alfabetin e saj në përputhje me ligjin.

Cilido qytetar i cili jeton në njësitë e vetadministrimit lokal, në të cilën së paku 20% e qytetarëve flasin gjuhë zyrtare të ndryshme nga gjuha maqedonase, në komunikim me njësitë rajonale të ministrive, mund ta përdorë cilëndo nga gjuhët zyrtare dhe alfabetin e saj. Njësitë rajonale kompetente për ato njësi të vetadministrimit lokal, përgjigjen në gjuhën maqedonase dhe alfabetin e saj cirilik, si dhe në gjuhën zyrtare dhe alfabetin të cilin e përdor qytetari. Çdo qytetar në komunikim me ministritë, mund ta përdorë njërën nga gjuhët zyrtare dhe alfabetin e saj, ndërsa ministritë përgjigjen në gjuhën maqedonase dhe alfabetin e saj cirilik, si dhe në gjuhën zyrtare dhe alfabetin të cilin e përdor qytetari.

Në organet e pushtetit shtetëror në Republikën e Maqedonisë, gjuha zyrtare e ndryshme nga gjuha maqedonase, mund të përdoret në përputhje me ligjin.

Në njësitë e vetadministrimit lokal gjuha dhe alfabeti që e përdorin së paku 20% e qytetarëve është gjuhë zyrtare, krahas gjuhës maqedonase dhe alfabetit të saj cirilik. Për përdorimin e gjuhëve dhe alfabeve, në të cilat flasin së paku 20% e qytetarëve në njësitë e vetadministrimit lokal, vendosin organet e njërive të vetadministrimit lokal.

2. Me këtë amendament zëvendësohet neni 7 i Kushtetutës së Republikës të Maqedonisë.

A M E N D A M E N T I V I

1. Përfaqësimi adekuat dhe i drejtë i qytetarëve, të cilët u takojnë të gjitha bashkësive, në organet e pushtetit shtetërorë dhe institucionet e tjera publike në të gjitha nivelet.

2. Me pikën 1 të këtij amendamenti, plotësohet alineja 2 e nenit 8 të Kushtetutës së Republikës të Maqedonisë.

A M E N D A M E N T I V I I

1. Kisha Ortodokse Maqedonase, si dhe Bashkësia Fetare Islame në Maqedoni, Kisha Katolike, Kisha Evangjeliste-Methodiste, Bashkësia Hebraike dhe bashkësitë e tjera fetare dhe grupet religjioze, janë të ndara nga shteti dhe janë të barabarta para ligjit.

2. Kisha Ortodokse Maqedonase, si dhe Bashkësia Fetare Islame në Maqedoni, Kisha Katolike, Kisha Evangjeliste-Methodiste, Bashkësia Hebraike dhe bashkësitë e tjera fetare dhe grupet religjioze, janë të lira në themelimin e shkollave fetare dhe enteve bamirëse dhe sociale në procedurë të parashikuar me ligj.

3. Me pikën 1 të këtij amendamenti zëvendësohet paragrafi 3 i nenit 19, ndërsa pika 2 zëvendësohet me paragrafin 4 të nenit 19 të Kushtetutës së Republikës të Maqedonisë.

A M E N D A M E N T I V I I I

1. Pjesëtarët e bashkësive kanë të drejtë lirisht ta shprehin, kultivojnë dhe zhvillojnë identitetin dhe veçoritë e bashkësive të tyre dhe t'i përdorin simbolet e bashkësisë së tyre.

Republika ua garanton të gjitha bashkësive mbrojtjen e identitetit etnik, kulturor, gjuhësor dhe fetar.

Pjesëtarët e bashkësive kanë të drejtë të themelojnë institucione kulturore, artistike, arsimore, si dhe shoqata shkencore dhe shoqata të tjera me qëllim të shprehjes, kultivimit dhe zhvillimit të identitetit të tyre.

Pjesëtarët e bashkësive kanë të drejtë të ndjekin mësimin në gjuhën e tyre në arsimin fillor dhe të mesëm, në mënyrë të përcaktuar me ligj. Në shkollat në të cilat arsimimi zhvillohet në gjuhë tjetër, mësohet edhe gjuha maqedonase.

2. Me këtë amendament zëvendësohet neni 48 i Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë.

A M E N D A M E N T I IX

1. Republika e garanton mbrojtjen, përparimin dhe pasurimin e thesarit historik dhe artistik të Maqedonisë dhe të të gjitha bashkësive në Maqedoni, si dhe të mirave që e përbëjnë atë, pa marrë parasysh regjimin e tyre juridik.

2. Me pikën 1 të këtij amendamenti zëvendësohet paragrafi 2 i nenit 56 të Kushtetutës së Republikës të Maqedonisë.

A M E N D A M E N T I X

1. Kuvendi mund të vendosë nëse në seancë merr pjesë shumica e numrit të përgjithshëm të deputetëve. Kuvendi vendos me shumicën e votave të deputetëve të pranishëm dhe së paku me një të tretën e numrit të përgjithshëm të deputetëve, nëse me Kushtetutë nuk është parashikuar shumicë e veçantë.

2. Për ligjet të cilët drejtpërsëdrejti kanë të bëjnë me kulturën, përdorimin e gjuhëve, arsimin, dokumentet personale dhe përdorimin e simboleve, Kuvendi vendos me shumicën e votave të deputetëve të pranishëm, me ç'rast medoemos duhet të ketë shumicë të votave nga deputetët e pranishëm të cilët u takojnë bashkësive që nuk janë shumicë në Republikën e Maqedonisë. Kontestin në lidhje me zbatimin e kësaj dispozite e zgjidh Komiteti për Marrëdhënie Ndërmjet Bashkësive.

3. Me këtë amendament zëvendësohet neni 69 i Kushtetutës së Republikës të Maqedonisë.

A M E N D A M E N T I XI

1. Kuvendi e zgjedh Avokatin e Popullit me shumicën e votave nga numri i përgjithshëm i deputetëve, me ç'rast duhet të ketë

shumicë të votave nga numri i përgjithshëm i deputetëve të cilët u takojnë bashkësive që nuk janë shumicë në Republikën e Maqedonisë.

2. Avokati i Popullit i mbron të drejtat kushtetuese dhe ligjore të qytetarëve të cilat u janë cenuar nga organet e administratës shtetërore dhe nga organet e organizatat e tjera të cilat kanë autorizime publike. Avokati i Popullit i përkushton vëmendje të veçantë mbrojtjes së parimeve të mosdiskriminimit, të përfaqësimit adekuat dhe të drejtë të pjesëtarëve të bashkësive në organet e pushtetit shtetëror, organet e njësive të vetadministrimit lokal dhe në institucionet dhe shërbimet publike.

3. Me pikën 1 të këtij amendamenti zëvendësohet paragrafi 1 i nenit 77, ndërsa me pikën 2 plotësohet paragrafi 2 i nenit 77 të Kushtetutës së Republikës të Maqedonisë.

AMENDAMENTI XII

1. Kuvendi themelon Komitetin për Marrëdhënie Ndërmjet Bashkësive.

Komitetin e përbëjnë 19 anëtarë prej të cilëve nga shtatë anëtarë nga radhët e deputetëve maqedonas dhe shqiptarë të Kuvendit dhe nga një anëtarë nga radhët e deputetëve turq, vllleh, romë, serbë dhe boshnjakë. Në qoftë se ndonjëra nga bashkësitë nuk ka deputet, Avokati i Popullit, pas konsultimeve me përfaqësues relevantë të atyre bashkësive, do t'i propozojë anëtarët e tjerë të Komitetit.

Kuvendi i zgjedh anëtarët e Komitetit.

Komiteti shqyrton çështje nga marrëdhëniet ndërmjet bashkësive në Republikë dhe jep mendime dhe propozime për zgjidhjen e tyre.

Kuvendi është i detyruar t'i shqyrtojë mendimet dhe propozimet e Komitetit dhe të merr vendime lidhur me to.

Në rast të kontestit lidhur me zbatimin e procedurës për votim në Kuvend, të përcaktuar me nenin 69 paragrafin 2, Komiteti vendos me shumicën e votave të anëtarëve, për atë se a do të zbatohet procedura.

2. Me pikën 1 të këtij amendamenti zëvendësohet neni 78 i Kushtetutës së Republikës të Maqedonisë dhe shlyhet alineja 7 e nenit 84 të Kushtetutës së Republikës të Maqedonisë.

AMENDAMENTI XIII

1. Gjatë emërimit të tre anëtarëve, Presidenti do të sigurojë që përbërja e Këshillit, si tërësi, në mënyrë përkatëse ta pasqyrojë përbërjen e popullatës në Republikën e Maqedonisë.

2. Me pikën 1 të këtij amendamenti plotësohet paragrafi 2 i nenit 86 të Kushtetutës së Republikës të Maqedonisë.

AMENDAMENTI XIV

1. Tre prej anëtarëve zgjidhen me shumicë votash nga numri i përgjithshëm i deputetëve, me ç'rast medoemos duhet të ketë shumicë të votave nga numri i përgjithshëm i deputetëve të cilët u takojnë bashkësive të cilat nuk janë shumicë në Republikën e Maqedonisë.

2. Me këtë amendament plotësohet paragrafi 2 i nenit 104 të Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë.

AMENDAMENTI XV

1. Kuvendi i zgjedh gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese. Kuvendi zgjedh gjashtë gjyqtarë të Gjykatës Kushtetuese me shumicën e votave nga numri i përgjithshëm i deputetëve. Kuvendi zgjedh tre gjyqtarë me shumicën e votave nga numri i përgjithshëm i deputetëve, me ç'rast medoemos duhet të ketë shumicë të votave nga numri i përgjithshëm i deputetëve të cilët u takojnë bashkësive të cilat nuk janë shumicë në Republikën e Maqedonisë. Mandati i gjyqtarëve zgjat nëntë vjet, pa të drejtë rizgjedhjeje.

2. Me këtë amendament zëvendësohet paragrafi 2 i nenit 109 të Kushtetutës së Republikës të Maqedonisë.

AMENDAMENTI XVI

1. Vetadministrimi lokal rregullohet me ligj i cili nxirret me shumicë prej dy të tretave të votave nga numri i përgjithshëm i deputetëve, me ç'rast medoemos duhet të ketë shumicë të votave nga numri i përgjithshëm i deputetëve të cilët u takojnë bashkësive të cilat nuk janë shumicë në Republikën e Maqedonisë. Ligjet për financimin lokal, zgjedhjet lokale, kufijtë komunalë dhe për Qytetin e Shkupit, nxirren me shumicën e votave nga deputetët e pranishëm, me ç'rast medoemos duhet të ketë shumicë të votave nga deputetët e pranishëm të cilët u takojnë bashkësive që nuk janë shumicë në Republikën e Maqedonisë.

2. Me këtë amendament zëvendësohet paragrafi 5 i nenit 114 të Kushtetutës së Republikës të Maqedonisë.

AMENDAMENTI XVII

1. Në njësitë e vetadministrimit lokal qytetarët në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe nëpërmjet përfaqësuesve marrin pjesë në vendimmarrje për çështje me rëndësi lokale, e veçanërisht në fushat e shërbimeve publike, urbanizmit dhe planifikimit rural, mbrojtjes së mjedisit jetësor, zhvillimit ekonomik lokal, financimit lokal, veprimtarive komunale, kulturës, sportit, mbrojtjes sociale dhe të fëmijëve, arsimit, mbrojtjes shëndetësore dhe në fusha të tjera të përcaktuara me ligj.

2. Në Qytetin e Shkupit qytetarët në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe nëpërmjet përfaqësuesve marrin pjesë në vendimmarrje për çështje me rëndësi për Qytetin e Shkupit, e veçanërisht në fushat e shërbimeve publike, urbanizmit dhe planifikimit rural, mbrojtjes së mjedisit jetësor, zhvillimit ekonomik lokal, financimit lokal, veprimtarive komunale, kulturës, sportit, mbrojtjes sociale dhe të

fëmijëve, arsimit, mbrojtjes shëndetësore dhe në fusha të tjera të përcaktuara me ligj.

3. Me pikën 1 të këtij amendamenti zëvendësohet paragrafi 1 i nenit 115 të Kushtetutës së Republikës të Maqedonisë, ndërsa me pikën 2 zëvendësohet paragrafi 2 i nenit 117 të Kushtetutës së Republikës të Maqedonisë.

AMENDAMENTI XVIII

1. Për vendimin mbi ndryshimin e Preambulës, neneve të vetadministrimit lokal, nenit 131, cilëso dispozitë që ka të bëjë me të drejtat e pjesëtarëve të bashkësive, përfshirë veçanërisht nenet 7, 8, 9, 19, 48, 56, 69, 77, 78, 86, 104 dhe 109, si dhe për vendimin për shtimin e çfarëdo dispozite të re, që ka të bëjë me përmbajtjen e atyre dispozitave dhe neneve, do të jetë e nevojshme shumicë prej dy të tretave të votave nga numri i përgjithshëm i deputetëve, me ç'rast medoemos duhet të ketë shumicë të votave nga numri i përgjithshëm i deputetëve të cilët u takojnë bashkësive të cilat nuk janë shumicë në Republikën e Maqedonisë.

2. Me këtë Amendament shtohet paragrafi i ri 4 të nenit 131 të Kushtetutës së Republikës të Maqedonisë.

AMENDAMENTI XIX^{*)}
i Kushtetutës së Republikës të Maqedonisë

Ky amendament është pjesë përbërëse e Kushtetutës së Republikës të Maqedonisë dhe hyn në fuqi me ditën e shpalljes së tij.

A M E N D A M E N T I X I X

1. Garantohet liria dhe pacenueshmëria e letrave dhe e të gjitha formave të tjera të komunikimit.

Vetëm në bazë të vendimit të gjykatës, në kushte dhe në procedurë të përcaktuara me ligj, mund të bëhet përjashtim nga e drejta e pacenueshmërisë së letrave dhe të gjitha formave të tjera të komunikimit, nëse kjo është e domosdoshme me qëllim të pengimit ose zbulimit të veprave penale, me qëllim të zhvillimit të procedurës penale ose kur atë e kërkojnë interesat e sigurisë dhe të mbrojtjes së Republikës.

Ligji nxirret me shumicën e dy të tretave të votave të numrit të përgjithshëm të deputetëve.

2. Me këtë amendament zëvendësohet neni 17 i Kushtetutës së Republikës të Maqedonisë.

*) Ky amendament është shpallur në "Gazetën zyrtare të Republikës së Maqedonisë", numër 84/2003.

AMENDAMENTET*)
XX, XXI, XXII, XXIII, XXIV, XXV, XXVI,
XXVII, XXVIII, XXIX dhe XXX
të Kushtetutës së Republikës të Maqedonisë

Këto amendamente janë pjesë përbërëse të Kushtetutës së Republikës të Maqedonisë dhe hyjnë në fuqi në ditën e shpalljes së tyre.

A M E N D A M E N T I X X

1. Për kundërvajtje të përcaktuara me ligj, sanksion mund të shqiptojë organi i administratës shtetërore ose organizata dhe organi tjetër që kryen autorizime publike.

Kundër vendimit të formës së prerë për kundërvajtje, garantohet mbrojtja gjyqësore në kushte dhe në procedurë të rregulluar me ligj.

2. Me këtë amendament plotësohet neni 13 i Kushtetutës së Republikës të Maqedonisë.

A M E N D A M E N T I X X I

1. Garantohet e drejta e ankesës kundër vendimeve të miratuara në procedurë të shkallës së parë para gjykatës.

E drejta e ankesës ose lloji tjetër i mbrojtjes juridike kundër akteve juridike të veçanta, të nxjerra në procedurë të shkallës së parë para organit të administratës shtetërore, ose organizatës dhe organit tjetër që kryen autorizime publike, rregullohet me ligj.

2. Me këtë amendament zëvendësohet neni 15 i Kushtetutës së Republikës të Maqedonisë.

*) Amendamentet janë shpallur në "Gazetën zyrtare të Republikës së Maqedonisë", numër 107/2005.

AMENDAMENTI XXII

1. Propozon dy anëtarë të Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë

2. Me këtë amendament zëvendësohet alineja 5 e nenit 84 të Kushtetutës së Republikës të Maqedonisë

AMENDAMENTI XXIII

1. Kryeministri gëzon imunitet. Për imunitetin e tij vendos Kuvendi.

2. Me këtë amendament zëvendësohet paragrafi 3 i nenit 89 të Kushtetutës së Republikës të Maqedonisë.

AMENDAMENTI XXIV

1. Propozon Prokuror Publik të Republikës së Maqedonisë me mendim paraprak të Këshillit të Prokurorëve Publikë;

2. Me këtë amendament zëvendësohet alineja 12 e nenit 91 të Kushtetutës së Republikës të Maqedonisë.

AMENDAMENTI XXV

1. Pushtetin gjyqësor e ushtrojnë gjykatat.

Gjykatat janë të mëvetësishme dhe të pavarura. Gjykatat gjykojnë në bazë të Kushtetutës e të ligjeve dhe të marrëveshjeve ndërkombëtare të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.

Ndalohen gjykatat e jashtëzakonshme.

Llojet, kompetencat, themelimi, suprimimi, organizimi dhe përbërja e gjykatave, si dhe procedura para tyre, rregullohen me ligj, i cili nxirret me shumicë prej dy të tretave të votave nga numri i përgjithshëm i deputetëve.

2. Me pikën 1 të këtij amendamenti zëvendësohet neni 98 i Kushtetutës së Republikës të Maqedonisë.

AMENDAMENTI XXVI

1. Gjyqtarit i pushon funksioni i gjyqtarit:

- nëse atë e kërkon vet;
- nëse e humb përgjithmonë aftësinë për ushtrimin e funksionit të gjyqtarit, të cilën e verifikon Këshilli Gjyqësor i Republikës së Maqedonisë;
- nëse i plotëson kushtet për pension pleqërie;
- nëse është dënuar me aktgjykim të plotfuqishëm gjyqësor për vepër penale me dënim të pakusht me burg me më së paku gjashtë muaj, dhe
- nëse është zgjedhur ose emëruar në funksion tjetër publik, përveçse kur funksioni i gjyqtarit pezullohet në kushte të përcaktuara me ligj.

Gjyqtari shkarkohet:

- për shkak të shkeljes së rëndë disiplinore që e bën të padenjë për ushtrimin e funksionit të gjyqtarit të përcaktuar me ligj, dhe
- për shkak të ushtrimit joprofesional dhe të pandërgjegjshëm të funksionit të gjyqtarit në kushte të përcaktuara me ligj.

2. Me pikën 1 të këtij amendamenti zëvendësohet paragrafi 3 i nenit 99 të Kushtetutës së Republikës të Maqedonisë.

AMENDAMENTI XXVII

1. Gjyqtari nuk mund të merret në përgjegjësi penale për mendimin e shprehur dhe për votën e dhënë me rastin e marrjes së vendimeve gjyqësore.

Gjyqtari nuk mund të arrestohet pa pëlqimin e Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë, përveç nëse është kapur në kryerje e sipër të veprës penale për të cilën është përcaktuar dënim me burg në kohëzgjatje prej së paku pesë vjet.

2. Funksioni i gjyqtarit nuk pajtohet me anëtarësimin në parti politike ose me ushtrimin e funksionit ose profesionit tjetër publik të përcaktuar me ligj.

3. Me pikën 1 të këtij amendamenti zëvendësohet paragrafi 2 i nenit 100 të Kushtetutës së Republikës të Maqedonisë, ndërsa me pikën 2 të këtij amendamenti zëvendësohet paragrafi 3 i nenit 100 të Kushtetutës së Republikës të Maqedonisë.

AMENDAMENTI XXVIII

1. Këshilli Gjyqësor i Republikës së Maqedonisë është organ i mëvetësishëm dhe i pavarur i gjyqësisë. Këshilli e siguron dhe e garanton mëvetësinë dhe pavarësinë e pushtetit gjyqësor.

Këshillin e përbëjnë pesëmbëdhjetë anëtarë.

Sipas funksionit anëtarë të Këshillit janë: Kryetari i Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë dhe Ministri i Drejtësisë.

Tetë anëtarë të Këshillit i zgjedhin gjyqtarët nga radhët e tyre. Tre nga anëtarët e zgjedhur janë pjesëtarë të bashkësive të cilët nuk janë shumicë në Republikën e Maqedonisë, me ç'rast do të respektohet përfaqësimi adekuat dhe i drejtë i qytetarëve të cilët u takojnë të gjitha bashkësive.

Tre anëtarë të Këshillit i zgjedh Kuvendi i Republikës së Maqedonisë me shumicën e votave nga numri i përgjithshëm i deputetëve, me ç'rast medoemos duhet të ketë shumicë të votave nga numri i përgjithshëm i deputetëve të cilët u takojnë bashkësive të cilat nuk janë shumicë në Republikën e Maqedonisë.

Dy anëtarë të Këshillit i propozon Presidenti i Republikës së Maqedonisë, ndërsa zgjedhjen e bën Kuvendi i Republikës së Maqedonisë, prej të cilëve njëri është pjesëtar i bashkësive të cilat nuk janë shumicë në Republikën e Maqedonisë.

Anëtarët e Këshillit që i zgjedh Kuvendi i Republikës së Maqedonisë, përkatësisht që i propozon Presidenti i Republikës së Maqedonisë janë nga radhët e profesorëve universitarë të drejtësisë, avokatëve dhe juristëve të tjerë të shquar.

Mandati i anëtarëve të zgjedhur të Këshillit zgjatë gjashtë vjet, me të drejtë edhe për një zgjedhje.

Kushtet dhe procedura për zgjedhjen, si dhe bazat dhe procedura për pushimin e funksionit dhe shkarkimin e anëtarit të Këshillit rregullohen me ligj.

Funksioni anëtar i zgjedhur i Këshillit nuk pajtohet me anëtarësimin në parti politike ose me ushtrimin e funksioneve dhe profesioneve të tjera publike të përcaktuara me ligj.

2. Me këtë amendament zëvendësohet neni 104 i Kushtetutës së Republikës të Maqedonisë.

AMENDAMENTI XXIX

1. Këshilli Gjyqësor i Republikës së Maqedonisë:

- zgjedh dhe shkarkon gjyqtarë dhe gjyqtarë porotë;
- verifikon pushimin e funksionit të gjyqtarit;
- zgjedh dhe shkarkon kryetarët e gjykatave;
- ndjek dhe vlerëson punën e gjyqtarëve;
- vendos për përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve;
- vendos për heqjen e imunitetit të gjyqtarëve;
- propozon dy gjyqtarë të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Maqedonisë nga radhët e gjyqtarëve; dhe
- kryen punë të tjera të përcaktuara me ligj.

Gjatë zgjedhjes së gjyqtarëve, gjyqtarëve porotë dhe kryetarëve të gjykatave do të respektohet përfaqësimi adekuat dhe i drejtë i qytetarëve të cilët u takojnë të gjitha bashkësive.

Këshilli për punën e tij i paraqet raport vjetor Kuvendit të Republikës së Maqedonisë, forma, përmbajtja dhe mënyra e miratimit të të cilit rregullohen me ligj.

2. Me këtë amendament zëvendësohet neni 105 i Kushtetutës së Republikës të Maqedonisë dhe shlyhet alinea 15 e paragrafit 1 të nenit 68 të Kushtetutës së Republikës të Maqedonisë.

AMENDAMENTI XXX

1. Prokuroria Publike funksionet e veta i ushtron në bazë të Kushtetutës e të ligjeve dhe të marrëveshjeve ndërkombëtare të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.

Funksionin e prokurorisë publike e ushtrojnë Prokurori Publik i Republikës së Maqedonisë dhe prokurorët publikë.

Kompetencat, themelimi, suprimimi, organizimi dhe funksionimi i Prokurorisë Publike rregullohet me ligj, i cili nxirret me shumicë prej dy të tretave të votave nga numri i përgjithshëm i deputetëve.

Prokurorin Publik të Republikës së Maqedonisë e emëron dhe e shkarkon Kuvendi i Republikës së Maqedonisë me kohëzgjatje prej gjashtë vitesh me të drejtë rizgjedhjeje.

Prokurorët publikë i zgjedh Këshilli i Prokurorëve Publikë pa kufizim të kohëzgjatjes së mandatit.

Gjatë zgjedhjes të prokurorëve publikë do të respektohet përfaqësimi adekuat dhe i drejtë i qytetarëve të cilët u takojnë të gjitha bashkësive.

Për shkarkimin e prokurorëve publikë vendos Këshilli.

Kompetencat, përbërja dhe struktura e Këshillit, mandati i anëtarëve të tij, si dhe bazat dhe procedura për pushimin dhe shkarkimin e anëtarit të Këshillit rregullohen me ligj.

Bazat dhe procedura për pushimin dhe shkarkimin e Prokurorit Publik të Republikës së Maqedonisë dhe të prokurorëve publikë rregullohet me ligj.

Funksioni Prokuror Publik i Republikës së Maqedonisë dhe prokuror publik nuk pajtohet me anëtarësimin në parti politike ose me ushtrimin e funksioneve dhe profesioneve të tjera publike të përcaktuara me ligj.

Ndalohet organizimi dhe veprimi politik në Prokurorinë Publike.

2 Me këtë amendament zëvendësohen paragrafët 2 dhe 3 të nenit 106 të Kushtetutës së Republikës të Maqedonisë dhe shlyhet neni 107 i Kushtetutës së Republikës të Maqedonisë.

AMENDAMENTI XXXI^{*)}
i Kushtetutës së Republikës të Maqedonisë

Ky amendament është pjesë përbërëse e Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë dhe hyn në fuqi në ditën e shpalljes së tij.

AMENDAMENTI XXXI

1. Për President është zgjedhur kandidati që ka fituar shumicën e votave të zgjedhësve që kanë votuar, nëse kanë votuar më shumë se 40% të zgjedhësve.

2. Me këtë amendament zëvendësohet paragrafi 5 i nenit 81 të Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë.

*) Ky amendament është shpallur në "Gazetën zyrtare të Republikës së Maqedonisë", numër 3/2009.

AMENDAMENTI XXXII^{*)}
i Kushtetutës së Republikës të Maqedonisë

Ky amendament është pjesë përbërëse e Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë dhe hyn në fuqi në ditën e shpalljes së tij.

AMENDAMENTI XXXII

1. Shtetasit të Republikës së Maqedonisë nuk mund t'i hiqet shtetësia, as nuk mund të dëbohet nga Republika e Maqedonisë. Shtetasi i Republikës së Maqedonisë nuk mund t'i dorëzohet shtetit tjetër, përveçse në bazë të Marrëveshjes së ratifikuar ndërkombëtare, me vendim gjyqësor.

2. Me këtë amendament zëvendësohet paragrafi 2 i nenit 4 të Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë.

*) Ky amendament është shpallur në "Gazetën zyrtare të Republikës së Maqedonisë", numër 49/2011

AMENDAMENTET^{*)}
XXXIII, XXXIV, XXXV DHE XXXVI
të Kushtetutës së Republikës të Maqedonisë

Këto amendamente janë pjesë përbërëse të Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë dhe hyjnë në fuqi në ditën e hyrjes në fuqi të Marrëveshjes përfundimtare për zgjidhjen e dallimeve të përshkruara në rezolutat 817 (1993) dhe 845 (1993) të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, për shfuqizimin e Marrëveshjes së Përkohshme të vitit 1995 dhe për vendosjen e partneritetit strategjik ndërmjet palëve dhe ratifikimin e Protokollit për anëtarësim në NATO nga pala e parë e Marrëveshjes përfundimtare.

AMENDAMENTI XXXIII

1. Në Kushtetutë fjalët: "Republika e Maqedonisë" zëvendësohen me fjalët: "Republika e Maqedonisë së Veriut", ndërsa fjala "Maqedonia" zëvendësohet me fjalët: "Maqedonia e Veriut", përveç në nenin 36 të Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë.

AMENDAMENTI XXXIV

1. Në Preambulën e Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë shlyhen fjalët: "si dhe qytetarët që jetojnë në kufijtë e saj që janë", "vendimet e KAÇKM-së" zëvendësohen me fjalët: "vendimet juridike që janë të theksuara në Proklamatën e Mbledhjes së Parë të KAÇKM-së për popullin maqedonas për mbledhjen e mbajtur të KAÇKM-së". Pas fjalës "vit" shtohen fjalët: "në të cilat u shpreh vullneti për krijimin e shtetit të pavarur sovran dhe Marrëveshjes Kornizë të Ohrit", ndërsa shlyhen fjalët: "vendosën ta".

2. Me këtë amendament bëhen ndryshime në Preambulë – Amendamenti IV i Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë.

*) Amendamentet janë shpallur në "Gazetën zyrtare të Republikës së Maqedonisë", numër 6/2019, ndërsa në "Gazetën zyrtare të Republikës së Maqedonisë", numër 36/2019 është publikuar Shpallja e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë për

hyrje në fuqi më 12 shkurt 2019 të amendamenteve XXXIII, XXXIV, XXXV dhe XXXVI të Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë.

AMENDAMENTI XXXV

1. Republika e respekton sovranitetin, integritetin territorial dhe pavarësinë politike të shteteve fqinje.

2. Me këtë amendament plotësohet neni 3 i Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë.

AMENDAMENTI XXXVI

1. Republika i mbron, garanton dhe kultivon veçoritë, trashëgiminë historike dhe kulturore të popullit maqedonas.

Republika i mbron të drejtat dhe interesat e shtetasve të vet të cilët jetojnë ose qëndrojnë jashtë vendit.

Republika kujdeset për diasporën e popullit maqedonas dhe për një pjesë të popullit shqiptar, popullit turk, popullit vllleh, popullit serb, popullit rom, popullit boshnjak, etj., dhe i kultivon dhe i avancoon lidhjet me atdheun.

Republika me këtë rast nuk do të përzihet në të drejtat sovrane të shteteve tjera dhe në punët e tyre të brendshme.

2. Me këtë amendament zëvendësohet neni 49 dhe Amendamenti II i Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë.

LIGJ KUSHTETUES^{*)}
PËR ZBATIMIN E KUSHTETUTËS
TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË

Neni 1

Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë zbatohet nga dita e shpalljes nga Kuvendi i Republikës së Maqedonisë, nëse për zbatimin e dispozitave të veçanta të saj me këtë ligj kushtetues nuk është përcaktuar ndryshe.

Neni 2

Kufiri shtetëror i Republikës së Maqedonisë është kufiri ekzistues i saj me Republikën e Shqipërisë, Republikën e Bullgarisë, Republikën e Greqisë dhe Republikën e Serbisë.

Neni 3

Republika e Maqedonisë si shtet sovran dhe i pavarur, pozitën e saj ndërkombëtare dhe marrëdhëniet me shtetet tjera dhe organet, organizatat dhe bashkësitë ndërkombëtare, i realizon sipas parimeve të përgjithshme të pranuara të së drejtës ndërkombëtare.

Republika e Maqedonisë si trashëgimtare e barabartë juridike e RSFJ-së me Republikat tjera, e merr anëtarësinë e RSFJ-së në organet, organizatat dhe bashkësitë ndërkombëtare.

^{*)} Ligji kushtetues është shpallur në “Gazetën zyrtare të Republikës së Maqedonisë” numër 52/1991

Neni 4

Republika e Maqedonisë si trashëgimtare e barabartë juridike e RSFJ-së me Republikat tjera, në bazë të marrëveshjes me Republikat tjera për trashëgiminë juridike të RSFJ-së dhe për marrëdhëniet e ndërsjella, i merr të drejtat dhe obligimet e dala nga krijimi i Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë.

Nëse nuk lidhet marrëveshje me Republikat tjera për trashëgiminë juridike të RSFJ-së dhe për marrëdhëniet e ndërsjella, trashëgimia juridike e RSFJ-së dhe marrëdhëniet e ndërsjella të Republikës së Maqedonisë me shtetet tjera sovraane të RSFJ-së përcaktohen në pajtim me rregullat e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare, si dhe në pajtim me Konventën e Vjenës për sukcesionin e shteteve në sferën e marrëveshjeve të vitit 1978 dhe Konventës së Vjenës, për sukcesionin e shteteve në sferën e pronës shtetërore, arkivit dhe marrëveshjeve nga viti 1982.

Neni 5

Dispozitat ekzistuese federative merren si republikane, me kompetenca të organeve të përcaktuara me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë.

Deri në arritjen e marrëveshjes ndërmjet shteteve sovraane të RSFJ-së, Republika e Maqedonisë mund t'ua besojë organeve federative zbatimin e dispozitave të caktuara.

Nëse organet nga paragrafi 2 i këtij neni, nuk i zbatojnë dispozitat në pajtim me sovranitetin dhe interesat e Republikës së Maqedonisë, ato i zbatojnë organet e republikës.

Dispozitat federative me të cilat rregullohet organizimi dhe kompetenca e organeve të Federatës, nuk zbatohen në Republikën e Maqedonisë.

Neni 6

Ligjet që nuk janë në pajtim me dispozitat e Kushtetutës të Republikës së Maqedonisë, do të harmonizohen në afat prej një viti nga dita e shpalljes së Kushtetutës.

Neni 7

Më së voni në afat prej gjashtë muajsh nga dita e shpalljes të Kushtetutës, do të miratohen:

- Ligji për Këshillin Gjyqësor Republikan;
- Ligji për gjykatat;
- Ligji për Prokurorinë Publike;
- Ligji për Avokatin e Popullit;
- Ligji për mënyrën e transformimit të pronës shoqërore;
- Ligji për shtetësinë e Republikës së Maqedonisë;
- Ligji për letërnjoftim;
- Ligji për kalimin e kufirit shtetëror dhe qarkullimin në brezin kufitar;
- Ligji për qarkullimin dhe qëndrimin e të huajve;
- Ligji për dokumentet e udhëtimit të shtetasve të Republikës së Maqedonisë;
- Ligji për mbrojtje të Republikës së Maqedonisë;
- Ligji për vetadministrim lokal, dhe
- Ligji për ndarjen territoriale të Republikës së Maqedonisë.

Neni 8

Ligji për stemën, flamurin dhe himnin e Republikës së Maqedonisë do të miratohet në afat prej gjashtë muajsh nga dita e shpalljes së Kushtetutës.

Deri në miratimin e Ligjit nga paragrafi 1 i këtij neni, zbatohen simbolet dhe himni ekzistues të përcaktuara në Kushtetutën e deritanishme të Republikës së Maqedonisë.

Neni 9

Shtetasit e republikave tjera në RSFJ, të cilët në ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji kushtetues kanë paraqitur vendbanim në territorin e Republikës së Maqedonisë ndërsa nuk kanë shtetësi të Republikës së Maqedonisë, do të mund të marrin shtetësinë e Republikës së Maqedonisë në pajtim me Ligjin për shtetësi të Republikës së Maqedonisë.

Neni 10

Kuvendi i Republikës së Maqedonisë në përbërjen ekzistuese të deputetëve, Kryetari i Republikës së Maqedonisë dhe Qeveria e Republikës së Maqedonisë, vazhdojnë t'i kryejnë funksionet me të drejtat dhe detyrat e përcaktuara me Kushtetutën deri në mbajtjen e zgjedhjeve të reja.

Dispozita e nenit 82 të Kushtetutës, do të zbatohet pas mbajtje së zgjedhjeve të reja, e më së voni deri në skadimin e mandatit për të cilin është zgjedhur Nënkryetari i Kryetarit të Republikës së Maqedonisë.

Nënkryetari i Kryetarit të Republikës së Maqedonisë, vazhdon t'i kryejë funksionet me të drejtat dhe detyrat e përcaktuara me Amendamentin LXXV të Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë, deri në mbajtjen e zgjedhjeve të reja, e më së voni deri në skadimin e mandatit për të cilin është zgjedhur.

Ligji për zgjedhjen e deputetëve në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë, Ligji për zgjedhjen e Kryetarit të Republikës së Maqedonisë dhe Ligji për parti të politike, do të miratohen më së voni tre muaj para mbajtjes së zgjedhjeve të reja.

Neni 11

Deri në arritjen e marrëveshjes ndërmjet shteteve sovraane të RSFJ-së, delegatët e Republikës së Maqedonisë në Kuvendin e RSFJ-së do t'i kryejnë funksionet e tyre, në pajtim me drejtimet e Kuvendit të Republikës së Maqedonisë.

Neni 12

Deri në arritjen e marrëveshjes ndërmjet shteteve sovraane të RSFJ-së, anëtari i Kryesisë së RSFJ-së nga Republika e Maqedonisë do t'i kryejë funksionet e veta në pajtim me drejtimet e Kuvendit të Republikës së Maqedonisë.

Neni 13

Forcat e armatosura të Republikës së Maqedonisë, deri në miratimin e Ligjit për mbrojtjen e Republikës së Maqedonisë, i përbëjnë njësitet, komandot dhe shtabet e mbrojtjes territoriale të Republikës së Maqedonisë.

Kryerja e shërbimit ushtarak të regrutëve dhe kryerja e obligimit ushtarak në përbërjen rezerve, do të kryhet në forcat e armatosura të Maqedonisë nga paragrafi 1 i këtij neni.

Neni 14

Përfaqësitë diplomatike dhe konsullore dhe qendrat kulturore-informative të RSFJ-së, do t'i përfaqësojnë interesat e Republikës së Maqedonisë si shtet sovran dhe i pavarur deri në arritjen e marrëveshjes, ndërmjet shteteve sovrane të RSFJ-së, deri në themelimin e përfaqësive të veta diplomatike, konsullore dhe qendrave kulturore-informative.

Neni 15

Zgjedhja e të gjithë gjyqtarëve në gjykata dhe emërimi i prokurorit publik sipas dispozitave të kësaj Kushtetute, do të kryhet më së voni në afat prej gjashtë muajsh, pas konstituimit të Këshillit Gjyqësor Republikan.

Këshilli Gjyqësor Republikan do të konstituohet më së voni në afat prej dy muajsh, pas miratimit të Ligjit për Këshillin Gjyqësor Republikan.

Deri në konstituimin e Këshillit Gjyqësor Republikan, nuk do të bëhet zgjedhja e gjyqtarëve në gjykata dhe emërimi i prokurorëve publikë në Prokuroritë Publike, të cilëve u ka skaduar mandati. Të njëjtit vazhdojnë të kryejnë funksionin deri në zgjedhjen, në pajtim me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë.

Neni 16

Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Maqedonisë, do të zgjidhen më së voni tre muaj pas konstituimit të Këshillit Gjyqësor Republikan.

Me ditën e zgjedhjes së gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Maqedonisë nga paragrafi 1 i këtij neni, gjyqtarëve ekzistues u pushon funksioni gjyqtar të Gjykatës Kushtetuese.

Neni 17

Këtë Ligj kushtetues e shpall Kuvendi dhe hyn në fuqi njëkohësisht me shpalljen e Kushtetutës.

LIGJ KUSHTETUES^{*)}
PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT
KUSHTETUES PËR ZBATIMIN E KUSHTETUTËS TË
REPUBLIKËS SË MAQEDONISË

Neni 1

Në Ligjin kushtetues për zbatimin e Kushtetutës të Republikës së Maqedonisë ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 52/1991), pas nenit 10 shtohet nen i ri 10-a, si vijon:

"Neni 10-a

Republika e Maqedonisë nuk do të marrë pjesë në punën e Kuvendit të RSFJ-së dhe në punën e Kryesisë të RSFJ-së, me ç'rast u ndërpritet funksioni delegatëve në Kuvendin e RSFJ-së nga Republika e Maqedonisë dhe anëtarit të Kryesisë së RSFJ-së nga Republika e Maqedonisë".

Neni 2

Nenet 11 dhe 12 shlyhen.

Neni 3

Ky Ligj kushtetues hyn në fuqi në ditën e shpalljes.

^{*)} Ligji kushtetues është shpallur në "Gazetën zyrtare të Republikës së Maqedonisë" numër 4/92

LIGJ KUSHTETUES^{*)}
PËR ZBATIMIN E AMENDAMENTEVE PREJ XX DERI XXX
TË KUSHTETUTËS SË REPUBLIKËS TË MAQEDONISË

Neni 1

Amendamentet prej XX deri XXX të Kushtetutës së Republikës të Maqedonisë zbatohen nga dita e shpalljes nga Kuvendi i Republikës së Maqedonisë, nëse për zbatimin e disa dispozitave nga Amendamentet me këtë Ligj kushtetues nuk është përcaktuar ndryshe.

Neni 2

Më së voni deri më 30 qershor 2006, do të miratohen:

- Ligji për Këshillin Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë;
- Ligji për gjykata dhe
- Ligji për kundërvajtje.

Neni 3

Më së voni në afat prej nëntë muajsh nga dita e shpalljes së Amendamenteve prej XX deri XXX të Kushtetutës së Republikës të Maqedonisë, do të miratohen:

- Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Prokurorinë Publike, dhe
- Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Qeverinë e Republikës së Maqedonisë.

Më së voni në afat prej 18 muajsh nga dita e shpalljes së Amendamenteve prej XX deri XXX të Kushtetutës së Republikës të Maqedonisë do të harmonizohen ligjet në bazë të të cilave organet e administratës shtetërore ose organizata dhe organi tjetër që kryen autorizime publike mund të kumtojnë sanksione për kundërvajtje të bërë.

^{*)} Ligji kushtetues është shpallur në "Gazetën zyrtare të Republikës së Maqedonisë" numër 107/2005

Neni 4

Deri në hyrjen në fuqi të Ligjit për gjykata dhe Ligjit për Këshillin Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë, zgjedhja dhe shkarkimi i gjyqtarëve do të bëhet sipas Ligjit për gjykata ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 36/95, 45/95 dhe 64/2003) dhe Ligjit për Këshillin Gjyqësor Republikan ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 80/92, 50/99 dhe 43/2003).

Neni 5

Deri në harmonizimin e Ligjit për Prokurorinë Publike me Amendamentet XXIV dhe XXX, prokurorët publikë do të zgjidhen në pajtim me Ligjin për Prokurorinë Publike ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 38/2004).

Neni 6

Deri në harmonizimin e Ligjit për Qeverinë e Republikës së Maqedonisë me Amendamentin XXIII, për imunitetin e Kryeministrit dhe të ministrave do të vendoset në pajtim me Ligjin për Qeverinë e Republikës së Maqedonisë ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 59/2000, 12/2003 dhe 55/2005).

Neni 7

Këtë Ligj kushtetues për zbatimin e Amendamenteve prej XX deri XXX të Kushtetutës së Republikës të Maqedonisë, e shpall Kuvendi i Republikës së Maqedonisë dhe hyn në fuqi njëkohësisht me shpalljen e Amendamenteve kushtetuese.

LIGJ KUSHTETUES *)
PËR ZBATIMIN E AMENDAMENTEVE NGA XXXIII
DERI XXXVI
të Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë

Neni 1

Amendamentet nga XXXIII deri XXXVI të Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë hyjnë në fuqi me hyrjen në fuqi të Marrëveshjes përfundimtare për zgjidhjen e dallimeve të përshkruara në Rezolutat 817 (1993) dhe 845 (1993) të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, për shfuqizimin e Marrëveshjes së Përkohshme të vitit 1995 dhe për vendosjen e partneritetit strategjik mes palëve dhe ratifikimin e Protokollit për anëtarësim në NATO nga Pala e parë e Marrëveshjes përfundimtare.

Amendamentet nga XXXIII deri XXXVI të Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë nuk prodhojnë veprim juridik, nuk hynë në fuqi dhe janë të pavlefshme nëse menjëherë nuk plotësohen kushtet e përcaktuara në paragrafin 1 të këtij neni.

Neni 2

Dispozitat nga amendamenti XXXIII në dispozitat dhe aktet tjera të organeve shtetërore zbatohen nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Nga dita e hyrjes në fuqi të amendamentit XXXIII, shtetësia do të jetë maqedonase/qytetar i Republikës së Maqedonisë së Veriut, që nuk e përcakton as nuk e prejudikon përkatësinë etnike të qytetarëve.

Shtetësia maqedonase/qytetar i Republikës së Maqedonisë së Veriut në dokumentet personale dhe në dokumentet e udhëtimit të qytetarëve shkruhet në gjuhën maqedonase dhe alfabetin e saj cirilik. Shtetësia maqedonase/qytetar i Republikës së Maqedonisë së Veriut në dokumentet personale dhe në dokumentet e udhëtimit të qytetarëve që flasin gjuhë zyrtare të ndryshme nga gjuha maqedonase dhe alfabeti i saj cirilik shkruhet në gjuhën maqedonase dhe alfabetin e saj dhe në atë gjuhë dhe alfabetin e saj dhe kjo do të përcaktohet në atë gjuhë në të gjitha ligjet ku duhet të zbatohet.

Nga dita e hyrjes në fuqi të amendamentit XXXIII, përdorimi i mbiemrit në lidhje me shtetin, organet shtetërore dhe institucionet publike dhe në lidhje me përdorimet tjera në pajtim me Marrëveshjen përfundimtare është në pajtim me emrin e shtetit ose me emrin e tij të shkurtuar dhe është "i Republikës së Maqedonisë së Veriut" ose "i Maqedonisë së Veriut".

*) Ligji kushtetues është shpallur në "Gazetën zyrtare të Republikës së Maqedonisë", numër 6/2019, ndërsa në "Gazetën zyrtare të Republikës së Maqedonisë", numër 36/2019 është publikuar Shpallja e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë për hyrje në fuqi më 12 shkurt 2019 të amendamenteve nga XXXIII, XXXIV, XXXV dhe XXXVI të Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë.

Neni 3

Dokumentet dhe materialet zyrtare ekzistuese të administratës publike për përdorim ndërkombëtar dhe dokumentet për përdorim të brendshëm të cilat mund të shfrytëzohen jashtë shtetit, do të harmonizohen me amendamentin XXXIII më së voni në afat prej pesë vitesh nga hyrja e tij në fuqi.

Neni 4

Harmonizimi me amendamentin XXXIII të dokumenteve dhe materialeve ekzistuese të dedikuara vetëm për përdorim të brendshëm do të fillojë me hapjen e çdo kapitulli nga fusha relevante në negociatat me Bashkimin Evropian, e do të mbarojë më së voni në afat prej pesë vitesh nga hapja e kapitullit.

Neni 5

Lidhur me zbatimin e amendamentit XXXV Republika e respektton sovranitetin, integritetin territorial dhe pavarësinë politike të shteteve fqinje: Republikës së Shqipërisë, Republikës së Bullgarisë, Republikës së Greqisë, Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë.

Neni 6

Këtë Ligj kushtetues për zbatimin e amendamenteve nga XXXIII deri XXXVI të Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë e

shpall Kuvendi i Republikës së Maqedonisë dhe hyn në fuqi në ditën e hyrjes në fuqi të amendamenteve kushtetuese.

PASQYRË

E DISPOZITAVE NGA KUSHTETUTA TË CILAT ZËVENDESOHEN, PLOTËSOHEN OSE SHLYHEN ME AMENDAMENTET E KUSHTETUTËS, OSE BËHET SHTIMI I DISPOZITAVE TË REJA TË KUSHTETUTËS

Preambula dhe dispozita nga Kushtetuta

Preambula e Kushtetutës
Në tërë tekstin e Kushtetutës

Neni	3
Neni	4
Neni	7
Neni	8
Neni	12
Neni	13
Neni	15
Neni	17
Neni	19
Neni	48
Neni	49
Neni	56
Neni	68
Neni	69
Neni	77
Neni	78
Neni	81
Neni	84
Neni	86
Neni	89
Neni	91
Neni	98
Neni	99
Neni	100
Neni	104
Neni	105
Neni	106
Neni	107
Neni	109
Neni	114
Neni	115
Neni	117
Neni	131

Amendamente

Amendamenti IV dhe XXXIV
Amendamenti XXXIII
Amendamenti I dhe XXXV
Amendamenti XXXII
Amendamenti V
Amendamenti VI
Amendamenti III
Amendamenti XX
Amendamenti XXI
Amendamenti XIX
Amendamenti VII
Amendamenti VIII
Amendamenti II dhe XXXVI
Amendamenti IX
Amendamenti XXIX
Amendamenti X
Amendamenti XI
Amendamenti XII
Amendamenti XXXI
Amendamentet XII dhe XXII
Amendamenti XIII
Amendamenti XXIII
Amendamenti XXIV
Amendamenti XXV
Amendamenti XXVI
Amendamenti XXVII
Amendamentet XIV dhe XXVIII
Amendamenti XXIX
Amendamenti XXX
Amendamenti XXX
Amendamenti XV
Amendamenti XVI
Amendamenti XVII
Amendamenti XVII
Amendamenti XVIII

PËRMBAJTJA

1. Parathënie	5
2. Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë me Amendamentet e Kushtetutës prej I deri XXXVI	10
3. Amendamente prej I deri XXXVI	74
4. Ligj kushtetues për zbatimin e Kushtetutës së Republikës të Maqedonisë	97
5. Ligj kushtetues për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit kushtetues për zbatimin e Kushtetutës së Republikës të Maqedonisë	103
6. Ligj kushtetues për zbatimin e amendamenteve XX deri XXX të Kushtetutës së Republikës të Maqedonisë	104
7. Ligj kushtetutës për zbatimin e amendamenteve XXXIII deri XXXVI të Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë së Veriut	106
7. Pasqyrë e dispozitave të Kushtetutës, të cilat zëvendësohen, plotësohen ose shlyhen me Amendamentet e Kushtetutës, ose bëhet shtimi i dispozitave të reja të Kushtetutës	109